



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. Prot.

Tiranë më 13.12.2024

V E N D I M
Nr. 59, datë 13.12.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Henri Naqellari	Kryesues
Loreta Hanxhari	Relatore
Bora Vrenjo	Anëtare

asistuar nga sekretarja e Sekretariatit Teknik, Znj. Lediana Azemaj, në datën 21.11.2024, ora 11:00, në Sallën e Mbledhjeve, kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I VLERËSIMIT: **Z. Ardit Selman Elmazi**, me funksion aktual Drejtor, në Drejtorinë Vendore të Kufirit dhe Migracionit, Shkodër.

OBJEKTI: **Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018**, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoi dhe vlerësoi shpjegimet dhe argumentimin ligjor të Relatorit të çështjes, Znj. Loreta Hanxhari, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në Ligjin nr. 12/2018, të ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr.12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar (në vijim Ligji 12/2018, i ndryshuar).
2. Bazuar në Nenin 6 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, shtetasi *Ardrit Elmazi* është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, për shkak të funksionit që mbante në momentin e hedhjes së shortit si *Zëvendësdrejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë dhe aktualisht si Drejtor në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Shkodër*.
3. Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, më datë 05.04.2022 ka shortuar Trupën Vlerësuese dhe më datë 04.07.2023 ka shortuar relatorin e çështjes për subjektin e vlerësimit *Z. Ardit Elmazi* për t’ju nënshtruar procesit të vlerësimit kalimtar, bazuar në dispozitat e Ligjit nr.12/2018, *i ndryshuar*, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Brendshme nr.07 datë 17.01.2023 “*Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit 12/2018, i ndryshuar*”, të përbërë nga Relatore Znj. Loreta Hanxhari, Kryesues Z. Henri Naqellari dhe Anëtare Znj. Bora Vrenjo.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, më datën 02/08/2023 u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit sipas nenit 27, pika 1 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar dhe neneve 30 dhe 31, të Kodit të Procedurave Administrative.
5. Trupa e Vlerësimit në përputhje me Ligjin 12/2018, të ndryshuar si edhe në bazë të Rregullores nr.197 dt.28.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, me Vendimin nr.1 datë 02.08.2023 vendosi:
 - *Të fillojë hetimi kryesisht për subjektin e vlerësimit Z. Ardit Elmazi me funksion aktual Drejtor në Drejtorinë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Shkodër.*
 - *Të njoftojë me shkrim subjektin e vlerësimit për fillimin e hetimit.*
 - *Të bëhet njohja e subjektit të vlerësimit me përbërjen e trupës së vlerësimit për të drejtën e deklarimit të konfliktit të interesit të subjektit me trupën.*

6. Bazuar në nenin 49 të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit *Ar Drit Elmazi* në datën 02.08.2023 është njoftuar në adresën elektronike zyrtare të tij, për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, është njohur me përbërjen e Trupës së Vlerësimit, dhe i është kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit sa më sipër.
7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, “Deklaratën për Konfliktin e Interesit” me nr. ** prot. datë 23.08.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e trupës së vlerësimit.
8. Relatori i çështjes në përmbushje të detyrave ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, dhe sipas:
 - nenit 7, pika 1 të Rregullores nr. 197 datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, nenit 4 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore dhe Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit, ka dërguar me shkresën nr. ** prot., datë 04.08.2023, pranë ILDKPKI-së, formularin e deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit .
 - nenit 7, pika 7 të Rregullores nr. 197 datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, ka dërguar me shkresën nr. ** prot., datë 04.08.2023, pranë DPPSH-së, formularin e aftësive profesionale për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
 - nenit 7, pika 4 të Rregullores nr. 197 datë 23.02.2023 “*Për hapat proceduralë të unifikuar*”, ka dërguar me shkresën nr. ** prot., datë 04.08.2023, pranë AMP-së, deklaratën e kontrollit të figurës për vlerësimin kalimtar të dorëzuar nga subjekti i vlerësimit.
9. Bazuar në nenin 34, pika 3, nenin 42, pika 1 dhe nenin 46, pika 2 të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar janë administruar raportet e hartuara nga institucionet ndihmëse: Inspektoriati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Agjencia e Mbikëqyrjes Policore (në vijim AMP) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (në vijim DPPSH). Këto raporte janë administruar nga relatori në fillim të procesit të hetimit administrativ.
10. Në vijim, relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të Nenit 25, të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
11. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, trupa e vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.

12. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve bazuar në Nenin 4, të Ligjit nr.12/2018 (i ndryshuar) ka për objekt:

- a) *vlerësimin e pasurisë;*
- b) *kontrollin e figurës;*
- c) *vlerësimin e aftësive profesionale.*

13. Trupa e vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a) Ligjin 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat” i ndryshuar.
- b) Ligjin nr.128/2021 “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”.
- c) Ligjin nr.40/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”.
- d) Ligjin nr. 49/2012 “ Për Gjykatën Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative”.
- e) Ligjin nr.9367 datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”.
- f) Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr.07 datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
- g) Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm nr.06, datë 17.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklarimit të Kontrollit të Figurës dhe Vlerësimit të Aftësive Profesionale për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik, si dhe mënyrën e plotësimit të tyre në zbatim të Ligjit nr.12/2018 të ndryshuar.
- h) Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Brendshëm dhe ILDKPKI nr. 15 datë 27.01.2023 “Për miratimin e formularëve të deklarimit të Pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme’ i ndryshuar.
- i) Rregulloren nr.197, datë 23.02.2023 “Për hapat proceduralë të unifikuar”.

Gjithashtu trupa e vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- *Deklarata e Pasurisë,*
- *Deklarata për Kontrollin e Figurës,*
- *Formulari i Vlerësimit Profesional*
- *Dokumentacion bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklarinimet,*
- *Tri raportet ndihmëse të hartuara nga institucionet shtetërore;*
- *Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar.*
- *provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit.*

- *ka marrë në konsideratë bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*

14. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3 pika 12 dhe 14 të ligjit 12/2018 të ndryshuar, nenit 3, pika 11 dhe nenit 5 të Ligjit nr.9367, datë 07.04.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”.

15. Trupa e vlerësimit, pasi dëgjoi relatimin e bërë nga relatorja e çështjes dhe studioi materialin e përgatitur për këtë qëllim, krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kanë nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatuan se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Ardit Elmazi, me Vendimin nr.2, datë 15.11.2024, vendosi:

- Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit Ardit Elmazi;
- Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht dhe*
 - *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët, e vlerësimit pasuror, kontrollit të figurës dhe atij profesional;*
- Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe me provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.12/2018, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t’u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

16. Me subjektin e vlerësimit, është komunikuar me anë të postës elektronike duke i bërë pyetje dhe kërkuar sqarime, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave.

17. Subjekti i vlerësimit, pas dërgimit të relacionit paraprak dhe njoftimit me e-mail datë 15.11.2024, mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Trupa Vlerësuese, nuk e ushtroi të drejtën e njohjes me dosjen dhe nuk paraqiti parashtrime.

II. SEANCA DËGJIMORE

18. Subjekti i vlerësimit Ardit Elmazi u ftua në seancë dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht me e-mail, në datën 18.11.2024, ku dhe u njoftua se seanca publike dëgjimore është përcaktuar për t’u mbajtur në datën 21.11.2024, ora 11:00, në adresën: Salla e Mbledhjeve Kati I, në ambientet e Ministrisë së Brendshme.

19. Seanca dëgjimore me subjektin u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, në datën dhe adresën e përcaktuar.

20. Subjekti i vlerësimit mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe për të parashtruar shpjegimet dhe opinionet e tij në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer

ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe të parashtrimeve, subjekti i vlerësimit Ardit Elmazi, kërkoi nga Trupa Vlerësuese konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

21. Z. Ardit Elmazi ka qenë bashkëpunues në procesin e vlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar dhe gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ ka zbatuar me përpikmëri afatet e përcaktuara nga Trupa Vlerësuese, si dhe ka sjellë prova dhe shpjegime kur i janë kërkuar. Subjekti ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore.

IV. ARSYETIMI LIGJOR I TRUPËS SË VLERËSIMIT

A. VLERËSIMI I PASURISË

22. Në bazë të nenit 32, pika 1, të ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, punonjësi deklaron çdo pasuri, të luajtshme apo të paluajtshme, të fituar, poseduar, përdorur apo tjetërsuar që nga data e fillimit të marrëdhënies së punës në institucionin përkatës, pavarësisht datës së emërimit në pozicionin dhe/ose gradën që mban, deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.

23. Trupa e Vlerësimit ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe fakt, për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për punonjësin dhe për personat e lidhur me të, të parashikuar në nenin 31, të ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

24. Deklarimi i pasurisë nga subjekti kryhet sipas parashikimeve të nenit 32 e 33, ndërsa procedura e vlerësimit të pasurisë nga trupa e vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34 të Ligjit 12/2018 të ndryshuar.

25. Sipas kreut III, neni 33/1, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ILDKPKI-ja bazuar në deklaratimet e pasurisë, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli dhe në përfundim përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

26. Hetimi administrativ i Trupës Vlerësuese pasi administroi dhe u njoh me Raportin e ILDKPKI-së, konsistoi në:

- *verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;*
- *në verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të deklaruara;*
- *në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;*

- në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaramëve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

27. Trupa e Vlerësimit për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë, ka thelluar hetimin nëpërmjet:

- a) shqyrtimit të të dhënave të deklaratës së pasurisë së vlerësimit kalimtar;
- b) krahasimit të deklaratave të pasurive të dorëzuara në ILDKPKI për periudhat përkatëse, në raport me të dhënat në deklaratën e vlerësimit kalimtar;
- c) shqyrtimit të të dhënave nga të gjitha bankat e nivelit të dytë, institucionet financiare dhe jofinanciare, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, organet tatimore, organet e tjera shtetërore, personat juridikë, individët, si dhe likuiditeteve – gjendje cash;
- ç) hetimit të kryer lidhur me të dhënat e vetëdeklaruara nga subjekti gjatë plotësimit të pyetësorëve të dërguar.

28. Trupa e Vlerësimit i ka vlerësuar këto deklaramëve së bashku me provat e tjera në tërësi dhe harmoni me të gjitha rrethanat e çështjes.

29. Subjekti i vlerësimit Z. Ardit Elmazi ka plotësuar dhe dorëzuar deklaratën e pasurisë dhe dokumentacion justifikues për të justifikuar vërtetësinë e deklaramëve, ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, në zbatim të nenit 32, pika 2 të ligjit nr.12/2018, i ndyshuar.

30. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33/1, pika 3 e ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka konstatuar se:

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

DEKLARIMI I PASURIVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT

1. Shtëpi banimi me sip. 147,40m² me hipotekë, në zk. 8370, me nr. pasurie **, me adresë: Rr. "Dervish Hekali", Pallati Rinia 04, kati **, ap. **, Njësia Bashkiake nr. 8, Tiranë, me kontratë porosie nr. ** kol, nr. ** rep., e lidhur me shoqërinë "Rinia 04" sh.p.k., me datën 06.03.2015. Vlera 7.000.000 lekë. Zotërimi 50%.
2. Garazh me sip. 15m², në zk. 8370, me nr. pasurie **, me kontratë porosie nr. ** kol, nr. ** rep., e lidhur me shoqërinë "Rinia 04" sh.p.k., në datën 06.03.2015. Vlera 700.000 lekë. Zotërimi 50%. Burimi i krijimit për të dy pasuritë e mësipërme: Kursime familjare ndër vite, huaja 2.500.000 lekë, e marrë tek Aulona - Pol sh.p.k., si dhe 2.500.000 lekë dhuruar nga babai i b/shortes Faik Bardhi, me datë 03.03.2015.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë porosie nr. ** kol, nr. ** rep., datë 06.03.2015, për apartament me sip. totale 176,9 m², si dhe parkim nr. **, në rrugën "Dervish Hekali", Tiranë. Porositës: Ardit

Elmazi. Sipërmarrës: Shoqëria "Rinia 04" sh.p.k. Vlera e ambienteve: 7.000.000 lekë, shumë e cila do të likuidohet në Raiffeisen Bank, në llogarinë e shoqërisë.

- Certifikatë për vërtetim pronësie nr. **, datë 21.10.2019, për pasurinë e llojit apartament me sip. 147,40m², me nr. pasurie **, në Tiranë, regjistruar në emër të Ardit Elmazi + Kartela e pasurisë (sipas kartelës sipërfaqe e përbashkët është 29,5m²) + Harta treguese e regjistrimit.
- Kontratë huaje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 02.03.2015, për shumën 17.860 euro. Huamarrës: Ardit Elmazi. Huadhënës: Shoqëria "Aulona-Pol" sh.p.k. Data e mbarimit të likuidimit të kësaj huaje do të jetë deri në momentin që pala huamarrëse të shesi shtëpinë ekzistuese. Huaja do të jetë pa interes.
- Deklaratë noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë 03.03.2015, lëshuar nga Faik Bardhi, i cili deklaroi se i ka dhuruar Ardit Elmazit, një shumë prej 2.500.000 lekë, të siguruar nga kursimet e tij personale.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

1.1.ASHK në zyrat/Drejtoritë vendore: Tirana Veri, Tirana Jug, Tirana Rurale 1, Tirana Rurale 2, nuk e konfirmojnë këtë pasuri të paluajtshme në emër të subjektit.

1.2.FSHU, me shkresën nr. ** prot., datë 21.09.2023, konfirmon se me gjeneralitetet Ardit Selman Elmazi, identifikohet 1 abonent me kontratën e furnizimit nr. TR2Axxx, kontratë familjare me adresë: Rruga "Dervish Hekali", Tiranë.

1.3.Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 12.09.2023, konfirmon se Ardit Elmazi, në datë 01.09.2008, ka depozituar në bankë një shumë prej 1.000.000 lekë, me përshkrimin "të ardhur nga punësimi" dhe në datë 02.03.2010 ka depozituar edhe një shumë tjetër prej 500.000 lekë, ku së bashku me interesat e përfituara ka ngelur një depozitë prej 1.521.422 lekë. Në datë 29.04.2013, pas shlyerjes së depozitës prej 1.627.075 lekë dhe interesat e përfituara, ka transferuar në Fondin Prestigj një shumë prej 1.704.700 lekë, fond i cili është shlyer në datën 05.03.2015, në llogarinë në lekë në Raiffeisen Bank, në shumën 2.018.446 lekë. Në këtë llogari në lekë, në datë 06.03.2015, shtetasi Faik Bardhi ka kredituar në llogarinë e Ardit Elmazit, një shumë prej 2.500.000 lekë, me përshkrimin "hua sipas deklaratës noteriale nr. ** rep., nr. ** kol." dhe në të njëjtën datë, Ardit Elmazi, me shumën e akumuluar nga fondi dhe transferimi i shtetasit Faik Bardhi, ka transferuar në llogarinë e shoqërisë "Rinia 04" sh.p.k., një shumë prej 4.508.000 lekë, me përshkrimin "kontratë porosie për blerje apartamenti + garazh, likujdim total". Raiffeisen Bank konfirmon gjithashtu, se në datë 04.03.2015, shoqëria "Aulona Pol" sh.p.k., ka transferuar në llogarinë e Ardit Elmazit, një shumë prej 17.801 euro, me përshkrimin "dhënie huaje në bazë të kontratës nr. **". Nga kjo shumë, Ardit Elmazi ka transferuar në llogarinë e shoqërisë "Rinia 04" sh.p.k., shumën 17.800 euro (me konvertim 2.492.000 lekë) me përshkrimin "kontratë porosie për blerje apartament + garazh, nr. ** rep., nr. ** kol., datë 06.03.2015". Në total, në datë 06.03.2015, Ardit Elmazi ka transferuar në llogarinë e shoqërisë "Rinia 04" sh.p.k., një shumë prej 7.000.000 lekë). Në datë

30.07.2018, Ardit Elmazi në Raiffeisen Bank ka marrë edhe një kredi në shumën 1.000.000 lekë, të cilën e ka tërhequr cash në datë 31.07.2018.

1.4.Raiffeisen Invest, me shkresën nr. ** prot., datë 30.10.2023, konfirmon se Ardit Elmazi, në datë 30.04.2013, ka bërë një blerje në fondin Raiffeisen Prestigj, në shumën 1.704.699 lekë, të cilën e ka tërhequr në datë 12.09.2014, në shumën 1.846.799 lekë. Më pas, ka kryer përsëri një blerje në datë 11.12.2014, në shumën 2.000.000 lekë, të cilën e ka tërhequr në datë 02.03.2015, në shumën 2.019.046 lekë (të evidentuara edhe në transaksionet e Raiffeisen Bank më lart).

1.5.QKB, me shkresën nr. ** prot., datë 13.09.2023, konfirmon se Faik Bardhi, figuron të jetë regjistruar në datë 07.06.2012 si PF, pajisur me NIPT L84207201T (sipas ekstraktit është regjistruar në datë 07.06.2018 dhe jo në datë 07.06.2012). Sipas ekstraktit, fusha e veprimtarisë është: Shërbime mjekësore nëpër institucione shëndetësore private. Vendi i ushtrimit të aktivitetit: Ndërtesa private 1-katëshe me nr. pasurie **, Krujë. Statusi: Aktiv.

1.6.DRT Durrës, me shkresën nr. ** prot., datë 27.09.2023, konfirmon se shtetasi Faik Bardhi, figuron i regjistruar me aktivitet në emër të tij, me NIPT L84207201T, me objekt aktiviteti "Aktivitete të mjekëve të specializuar", në Krujë. Sipas deklarimeve, ky tatimpagues ka këto të dhëna:

Nr.	Periudha	Të ardhurat tatimore	Fitimi tatimor
1	2018	998.062	970.304
2	2019	1.580.910	491.295
3	2020	1.751.350	1.330.684
4	2021	1.618.460	1.593.980
5	2022	1.973.280	1.877.483

1.7.ISSH, me shkresën nr. ** prot., datë 15.09.2023, konfirmon se Mjaftime Elmazi, nga muaji prill 2013, përfiton pension pleqërie me masë mujore aktuale 27.969 lekë, ndërsa Faik Bardhi, për periudhën janar 2012 - mars 2015 (muaji kur ishte dhënë shuma 2.500.000 lekë për blerjen e apartmentit), rezulton i punësuar/ka përfituar të ardhura pranë institucioneve: Drejtoria e Shërbimit Spitalor Krujë; Hygea Hospital Tirana/International Hospital; Expo Confeksion; dhe Ëisdrom, dhe për periudhën në fjalë shuma totale e të ardhurave, për të cilat janë paguar kontributet, është në shumën 7.728.925 lekë.

1.8.ISSH Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. ** prot., datë 21.09.2023, konfirmon të dhëna punësimi për Mjaftime Elmazi, për periudhën 1963 - 1977, si dhe për Faik Bardhin (pa periudhë).

1.9.Në ILDKPKI janë administruar:

- Librezë pune për Faik Bardhi, për periudhën 1983 - 2009.
- Vërtetim nr. ** prot, datë 09.12.2016, lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor "Dr. Stefan Gjoni", Krujë, për të ardhurat e Faik Bardhi, ku evidentohet se për periudhën

- janar 2012 - mars 2015 (muaj kur është dhuruar shuma 2.500.000 lekë), ka përfituar të ardhura neto në shumën 2.805.258 lekë.
- Vërtetim nr. ** prot., datë 07.12.2016, lëshuar nga shoqëria "Expo Confeksion" sh.p.k.. për të ardhurat e Faik Bardhi, ku evidentohet se për periudhën janar 2014 - mars 2015 (muaj kur është dhuruar shuma 2.500.000 lekë), ka përfituar të ardhura neto në shumën 287.512 lekë.
 - Vërtetim nr. ** prot., datë 09.12.2016, lëshuar nga spitali "Hygeia" për të ardhurat e Faik Bardhi, ku evidentohet se për periudhën korrik 2012 - mars 2015 (muaj kur është dhuruar shuma 2,500.000 lekë), ka përfituar të ardhura neto në shumën 3.995.391 lekë.

1.10. Me proces-verbalin e datës 04.03.2024, subjektit iu kërkuan shpjegime dhe dokumente justifikuese për blerjen e apartamentit dhe garazhit dhe burimet financiare të përdorura, si dhe adresat e banimit ndër vite.

1.11. Me inventarët e datave 11.03.2024 dhe 18.03.2024 pranë ILDKPKI, subjekti paraqiti dokumente justifikuese dhe shpjegimet me shkrim, ku, në mënyrë të përmbledhur sqaroi se, përsa i përket cmimit të deklaruar të apartamentit dhe garazhit në deklaratën e pasurisë në vlerën 7.700.000 lekë, ka qenë një ngatërresë në deklaram, pasi ka dashur të deklarojë që vlera totale e paguar ka qenë 7.000.000 lekë, 6.200.000 lekë për apartmentin dhe 800.000 lekë për garazhin. Subjekti shpjegoi se cmimi i apartamentit 6.200.000 lekë, ka ardhur si rrjedhojë e porositjes së tij në gropë dhe negocimit të cmimit me ndërtuesin, pasi atij i duheshin likuiditete të momentit, nga situata emergjente që kishte. Për moskonfirmimin e këtyre pasurive nga ASHK, subjekti shpjegoi se kjo duhet të jete problem i sistemit të ASHK-së, pasi ai disponon certifikatat e pronësive për to. Lidhur me huanë e marrë nga shoqëria "Aulona-Pol", sh.p.k., sqaroi se, duke qenë se me ish-administratorin e "Aulona-Pol", shtetasin Agim Alimema, ka pasur marrëdhënie miqësie dhe shoqërie, afati i huasë ka qenë i lidhur me shitjen e apartamentit tjetër (i trajtuar me poshtë) i cili akoma nuk është shitur sepse është lënë kolateral për kredinë e marrë nga babai dhe vëllai i subjektit. Me administratorin e kësaj shoqërie apo me vet shoqërinë "Aulona - Pol" sh.p.k., nuk ka pasur marrëdhënie interesi për shkak të detyrës. Huaja do të shlyhet kur të bëhet shitja e apartamentit. Lidhur me burimet financiare të vjehrrit, subjekti shpjegoi se dokumentet justifikuese për të i ka depozituar në kontrollet e mëparshme si subjekt deklarimi. Lidhur me përdorimin e garazhit dhe plotësimin e nevojave të transportit, kur nuk ka pasur automjet, ato janë plotësuar me transport publik, pasi dhe vendndodhja e apartmentit ku banon është e favorshme për përdorimin e transportit publik. Në këtë apartment subjekti dhe familja e tij jetojnë prej vitit 2018, pas përfundimit të ndërtimit të tij. Shpenzimet e mobilimit për këtë apartment kanë qenë rreth 1.000.000 lekë, ku si burim financiar ka shërbyer kredia e marrë në Raiffeisen Bank në vitin 2018.

Bashkëlidhur paraqiti:

- Kontratë shitblerje pasuri e paluajtshme nr. ** rep., nr. ** kol., datë 18.10.2019, për pasuritë apartment me sip. 147,40 m2, me nr. pasurie ** dhe garazh me sip. 15 m2, me nr. pasurie **. Blerës: Ardit Elmazi. Shitës: Shoqëria ndërtimore "Rinia 04" sh.p.k.

- cmimi: 6.200.000 lekë apartamenti dhe 800.000 lekë garazhi, vlerë e likuiduar tërësisht sipas kontratës së porosisë nr. ** rep., nr. ** kol., datë 06.03.2015.
- Certifikatë për vërtetim pronësie datë 21.10.2019, për pasurinë e llojit apartament me sip. 147,40 m2, me nr. pasurie **, regjistruar në emër të Ardit Elmazi + Kartela e pasurisë + Harta treguese e regjistrimit.
 - Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 21.10.2019, për pasurinë e llojit garazh me sip. 15 m2, me nr. pasurie **, regjistruar në emër të Ardit Elmazi. + Kartela e pasurisë. + Harta treguese e regjistrimit.
 - Ekstrakt regjistrimi në QKB i shoqërisë "Aulona-Pol-1" sh.p.k.
 - Kartela e llogarisë printuar nga programi "Alpha Bussines" i shoqërisë "Aulona -Pol - 1", datë 06.03.2024, ku evidentohet se në datë 02.03.2015 është bërë debitimi i llogarisë në shumën 17.860 euro/2.500.400 lekë, me përshkrimin "Dhënia hua Ardit Elmazi". + Pasqyrat financiare të shoqërisë, për periudhën 01.01.2015 - 31.12.2015.
 - Deklaratë noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë 08.03.2024, lëshuar nga administratori i shoqërisë "Aulona - Pol - 1" sh.p.k., V. M., i cili deklaron se në muajin mars 2015, nga llogaritë e shoqërisë i është dhënë hua pa interes shtetasit Ardit Elmazi, në shumën 17.860 euro, vlerë e cila ende nuk është shlyer, pasi është rënë dakord që do të shlyhet në momentin që Ardit Elmazi do të shesë banesën e tij të parë.
 - Kartela e llogarisë, printuar nga programi "Alpha Bussines" i shoqërisë "Aulona -Pol - 1", datë 11.03.2024, ku evidentohet se në datë 10.03.2023, vjen ende i mbartur detyrimi që Ardit Elmazi i ka kësaj shoqërie, në shumën 17.860 euro/2.500.400 lekë.
 - Kontratë kredie datë 24.07.2018, për kredi në shumën 1.000.000 lekë. Kredimarrës: Ardit dhe Shpresjona Elmazi. Kredidhënes: Raiffeisen Bank. Qëllimi: Personale.
 - Faturë tatimore shitje nr. **, datë 04.08.2018, për blerje dhomë gjumi. Blerës: Ardit Elmazi. Shuma 120.000 lekë.
- 1.12. Me inventarin e datës 22.04.2024, subjekti paraqiti pranë ILDKPKI-së: Deklaratë noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë 18.04.2024, lëshuar nga shoqëria, "Rinia-04" sh.p.k., përfaqësuar nga administratori i saj J. M., i cili deklaron se në lidhje me kontratën e porosisë nr. ** kol, nr. ** rep., datë 06.03.2015, lidhur mes shoqërisë "Rinia-04" sh.p.k., dhe Ardit Elmazit, për blerjen e një apartamenti me sip. 147,7m2, me cmimin 6.200.000 lekë dhe garazhit me sip. 15m2, me cmimin 800.000 lekë, cmimet e mësipërme i'a ka ofruar Ardit Elmazit, pasi sapo kishte filluar punimet (hapjen e gropës dhe hedhjen e plintave) dhe kishte nevojë imediate për likuiditete të menjëhershme për shlyerjen e detyrimeve që kishin lindur për pallatin deri në atë fazë.
- 1.13. Bazuar në deklarimin e subjektit, sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur rezulton se: Në vitin 2015, subjekti ka porositur nga shoqëria "Rinia" sh.p.k., një apartament (me cmimin 6.200.000 lekë) dhe një garazh (me cmimin 800.000 lekë) në Rrugën "Dervish Hekali", në Tiranë, për shumën totale 7.000.000 lekë. Si burim financiar për plotësimin e shumës 7.000.000 lekë, subjekti ka përdorur 2.500.000 lekë dhuratë nga vjehri i tij Faik Bardhi, rreth 2.500.000 lekë nga një hua e marrë nga subjekti prej shoqërisë "Aulona Pol" sh.p.k., si dhe rreth 2.000.000 lekë nga pakësimi i një fond investimi në Raiffeisen Bank, fond i cili ka pasur burim financiar kursime të subjektit dhe interesat e përfituara nga vet investimi. Për burimet financiare të vjehrit, subjekti

ka paraqitur dokumente justifikuese për të ardhurat e tij nga punësimi, ndërsa për huanë e marrë nga shoqëria "Aulona Pol" sh.p.k., subjekti ka paraqitur dokumente justifikuese, që evidentojnë dhënien e huasë nga shoqëria dhe regjistrimin e saj në kartelën e llogarive të shoqërisë, e cila është ende e pashlyer. Kontrata përfundimtare e shitblerjes për këtë apartament është lidhur në vitin 2019.

1.14. Referuar të dhënave të tregut të lirë të apartamenteve, sipas EKB, kosto e shitjes lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi, në qytetin e Tiranës, në vitin 2015, në zonën 8/2 (Rruga "Dervish Hekali") ka qenë 100.000 lekë/m², kosto kjo më e lartë se kosto e përlogaritur për porositjen e apartamentit nga ana e subjektit, prej 42.062 lekë/m².

1.15. Lidhur me cmimin e ulët, subjekti shpjegoi se cmimi i apartamentit 6.200.000 lekë, ka ardhur si rrjedhojë e porositjes së tij në grupë dhe negocimit të cmimit me ndërtuesin, pasi atij i duheshin likuiditete të momentit nga situata emergjente që kishte, për të cilën paraqiti edhe deklaratë noteriale të lëshuar nga shoqëria ndërtuese. Në këtë apartament, subjekti banon prej vitit 2018 dhe për mobilimin e tij deklaron se ka shpenzuar rreth 1.000.000 lekë, me burim një kredi të marrë në Raiffeisen Bank, në vitin 2018.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti për blerjen dhe burimin financiar të përdorur për apartamentin dhe garazhin, në rrugën "Dervish Hekali", Tiranë, të cilat nuk konfirmohen nga ASHK Tiranë, por subjekti ka paraqitur certifikatat për vërtetim pronësie të tyre.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë me kursime familjare.**

2. Tokë bujqësore, me adresë: fshati Krahës Tepelenë, me sip. 550 m², e përfituar në bazë të ligjit nr. 7501. Zotërimi 100%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- AMTP nr. **, për familjen e Ardit Elmazi, në fshatin Lulzim, Tepelenë, për tokë arë me sip. 550 m².
- Vërtetim nga Këshilli i Rrethit Tepelenë, datë 28.08.2000, i cili vërteton se Ardit Elmazi ka përfituar tokë të llojit arë, me sip. 550 m², nga ligji 7501.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

2.1.ASHK Tepelenë, me shkresën nr. ** prot, datë 25.10.2023, konfirmon se në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të, nuk rezultojnë të regjistruara pasuri të paluajtshme dhe as në proces legalizimi.

2.2.Me proces-verbalin e datës 04.03.2024, subjektit ju kërkuan shpjegime dhe dokumente justifikuese lidhur me tokën bujqësore të deklaruar.

2.3.Me inventarin e datës 11.03.2024, subjekti paraqiti dokumente justifikuese dhe shpjegime me shkrim, ku, në mënyrë të përmbledhur sqaroi se, për këtë pasuri ende nuk ka aplikuar në hipotekë për nxjerrje certifikatë pronësie. Duke qenë se vendndodhja e tokës është e paarritshme dhe e pashfrytëzueshme nga ana e subjektit, i'a ka lënë xhaxhait të tij, H. Elmazi, pa kundërshtëpërblim, për ta përdorur duke i dhënë edhe shpjegimin që këtë tokë ta mbjellë me ullinj, ashtu si ka mbjellë edhe token e tij që është ngjitur me tokën e subjektit. Fidanët e gjithë tokës së tij dhe të xhaxhait, 83 fidanë në total, janë mbjellë nga xhaxhai me kursimet e tij.

Bashkëlidhur:

- Deklaratë noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë 06.03.2024, lëshuar nga H. Elmazi, i cili deklaron se në gastrën me emërtimin Bregadovë **, me emërtimin arë, me sip. totale 1.600m2, ka mbjellë rrënjë ulliri, ashtu si dhe në parcelën kufitare me sip. 500 m2, në emrin e nipit Ardit Elmazi, të cilën e shfrytëzon me pëlqimin e nipit.
- AMTP nr. ** për familjen e H. Elmazi, në fshatin Lulzim, Tepelenë, për tokë arë me sip. 400 m2; 3.100 m2; dhe 1.600 m2.
- Ortofoto satelitore ku evidentohen ngastra toke të mbjella me pemë dhe skicim me shkrim dore, me emërtimin Ardit Elmazi dhe H. Elmazi.

2.4.Bazuar në deklarimin e subjektit, sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se: Subjekti, nëpërmjet ligjit nr. 7501, ka përfituar një sipërfaqe toke arë prej 550 m2, në fshatin Lulzim, Tepelenë, të cilën nuk e ka regjistruar ende në ASHK. Nisur nga vendndodhja e saj, subjekti tokën i'a ka lënë në shfrytëzim xhaxhait të tij, i cili ka edhe një sipërfaqe toke të tijën, kufitare me tokën e subjektit.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti, lidhur me përfitimin e pronësisë dhe përdorimin e tokës me sip. 550 m2 në fshatin Lulzim, Tepelenë. ASHK Tepelenë, nuk e konfirmon të regjistruar në emër të subjektit këtë pasuri, por subjekti ka shpjeguar se ende nuk ka aplikuar për regjistrim.**

3. Depozitë bankare pranë Raiffeisen Bank, në emër të djalit Dion Elmazi, e hapur në datën 03.09.2010. Gjendja e depozitës në datën 07.03.2023 është 1.216.727 lekë. Burimi i krijimit: Pagat e mia.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

3.1.Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 12.09.2023, konfirmon se Dion Elmazi, në datë 10.03.2023, ka llogari rrjedhëse me gjendje 1.216.726 lekë. Nga të dhënat bankare evidentohet se kjo llogari ka si burim financiar pagesa (thuajse) periodike prej vitit 2010, nga llogaria e babait Ardit Elmazi, në shuma nga 5.000 lekë - 10.000 lekë, si dhe nga interesat e vetë llogarisë.

✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e Raiffeisen Bank.**

- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë me kursime familjare.**

4. Shtëpi banimi me sip. 75 m2, me hipoteke, në emër të Shpresjona Elmazi, b/shortja, me adresë: Rr. "4 Dëshmorët", pallati **, ap. nr. **, Tiranë. Me kontratë shitblerje apartamenti nr. ** rep., datë 28.09.2007, midis shitësit F. M. dhe blerësit Shpresjona Elmazi, në shumën 1.900.000 lekë, nga kursimet familjare ndër vite të nuses dhe kursimet e mia ndër vite. Zotërimi 50%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vetëdeklarim nr. ** prot., datë 15.09.2006, për legalizimin e shtesës anësore me dy kate, në objektin e ndodhur në rrugën "4 Dëshmorët", Tiranë. Sipërfaqja e ndërtimit: 25,55 m2. Numri i kateve: 2. Vetëdeklarues: F. M. dhe S. R.
- Kontratë shitblerje apartamenti nr. ** rep., nr. ** kol., datë 28.09.2007, për apartament me sip. 51,7 m2, me nr. pasurie **, në rrugën "4 Dëshmorët" Tiranë. Blerës: Shpresjona Elmazi. Shitës: F. M. Cmimi: 1.900.000 lekë, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Deklarate noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë 14.12.2010, lëshuar nga F. M. e B. M. dhe Shpresjona Elmazi, të cilët pranojnë se me kontratën e shitjes nr. ** rep., nr. ** kol., datë 28.09.2007, F. M. i ka shitur Shpresjona Elmazit pasurinë apartament me sip. 51,7 m2m në rrugën "4 Dëshmorët", Tiranë dhe bashkë me apartamentin, të përfshirë në cmim i ka shitur edhe shtesën me sip. 25,55 m2, sipas vetëdeklarimit për legalizim nr. ** prot., datë 15.09.2006. Me këtë deklaratë F. M. është dakord që leja e legalizimit për shtesën, të dali në emër të Shpresjona Elmazit.
- Kërkesë datë 24.12.2010, për ndryshim emri në procedurat e legalizimit, bërë nga Shpresjona Elmazi, për shtesën me sip. 25,55 m2, në apartamentin me sip. 51,7 m2, në rrugën "4 Dëshmorët", Tiranë.
- Kartela e pasurisë së paluajtshme datë 02.03.2023, për pasurinë e llojit apartament, me sip.75 m2, me nr. pasurie **, në rrugën "4 Dëshmorët", Tiranë, regjistruar në emër të Shpresjona Elmazi, dhe Certifikata e regjistrimit të pronësisë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

4.1.Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** pro., datë 12.09.2023, konfirmon se në datë 24.08.2007, shtetasi H. Elmazi ka depozituar një shumë prej 1.200.000 lekë, ndërsa në datë 29.08.2007, Ardit Elmazi ka depozituar një shume prej 500.000 lekë. Nga shuma e akumuluar në këtë llogari prej 1.700.000 lekë, në datë 17.09.2007, Ardit Elmazi ka tërhequr cash një shumë prej 1.500.000 lekë dhe në datë 26.12.2007 edhe një shumë tjetër prej 200.000 lekë.

4.2.ProCredit Bank, me shkresën nr. 68/7 prot., datë 13.09.2023, konfirmon se në datë 13.11.2007, shoqëria "Aulona-Pol", i ka kredituar Ardit Elmazit në llogari, një shumë prej 700.000 lekë, me përshkrimin "dhënie borxhi". Në këtë llogari, në datë 16.11.2007, shtetasi L. H. ka depozituar cash edhe një shumë prej 300.000 lekë. Në po të njejtën datë, Ardit Elmazi ka debituar llogarinë e tij me shumën 300.000 lekë dhe 700.000 lekë (për një total prej 1.000.000 lekë).

4.3.ASHK Drejtoria e Përgjithshme, me shkresën nr. ** prot., datë 23.10.2023, konfirmon se në sistemin digital të vendimeve të legalizimit, rezulton e pajisur me vendim legalizimi shtetasja Shpresjona Faik Elmazi, nr. vendimit **, datë 11.10.2016, apartamenti 2, shtesë anësore 3 kat, në objektin ekzistues 3-kat, në zk. 8370.

4.4.ASHK Tirana Veri, me shkresën nr. ** prot., datë 06.11.2023, konfirmon se në emër të Shpresjona Elmazi, figuron e regjistruar pasuria e llojit apartament, me sip. 75 m2, me nr. pasurie ** në rrugën "4 Dëshmorët", Tiranë, regjistruar më datë 30.08.2022. Pasuria është rivlerësuar në vitin 2017, në vlerat: 5.170.000 lekë; 770.000 lekë dhe 1.540.000 lekë. Kjo pasuri është bllokuar në favor të BKT, për shumën 5.424.000 lekë.

Bashkëlidhur:

- Kontratë shitblerje apartamenti nr. ** rep., nr. ** kol., datë 28.09.2007, për apartament me sip. 51,7 m2, me nr. pasurie 5/218+1-6, në rrugën "4 Dëshmorët" Tiranë. Blerës: Shpresjona Elmazi. Shitës: F. M. cmimi: 1.900.000 lekë, i likuiduar jashtë zyrës noteriale.
- Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 08.10.2007, për pasurinë e llojit apartament me sip. 51,7 m2, me nr. pasurie **, në emër të Shpresjona Elmazi. Regjistruar në kartelë me kontratë shitje në shumën 1.900.000 lekë. Pasuria ishte rivlerësuar në datë 26.05.2017, në vlerën 5.170.000 lekë. Kjo pasuri është bllokuar në favor të BKT, për shumën 5.424.000 lekë.
- Certifikatë për vërtetim pronësie datë 28.10.2016, për pasurinë e llojit apartament me sip. 7,70 m2, me nr. pasurie **, regjistruar në kartelë me leje legalizimi për shtesë anësore dhe e rivlerësuar në datë 26.01.2017, në vlerën 770.000 lekë.
- Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 31.10.2016, për pasurinë e llojit apartament me sip. 15,40 m2, me nr. pasurie **, regjistruar në kartelë me leje legalizimi për shtesë anësore dhe rivlerësuar në datë 26.01.2017, në vlerën 1.540.000 lekë, të regjistruara në emër të Shpresjona Elmazi.

4.5.FSHU, me shkresën nr. ** prot, datë 21.09.2023, konfirmon se me gjeneralitetet Shpresjona Faik Elmazi, identifikohet 1 abonent me kontratën e furnizimit nr.TR2P xxx, kontratë familjare me adresë: rruga "4 Dëshmorët", Tiranë.

4.6.Me proces-verbalin e datës 04.03.2024, subjektit i'u kërkuan shpjegime dhe dokumente justifikuese lidhur me blerjen e apartmentit, përdorimin e tij ndër vite, konfirmimin nga ASHK se ky apartament rezulton i bllokuar si hipotekë, si dhe transaksionet e konfirmuara në Raiffeisen dhe ProCredit Bank.

4.7.Me inventarin e datës 11.03.2024 dhe 18.03.2024, subjekti paraqiti dokumente justifikuese dhe shpjegimet me shkrim, ku, në mënyrë të përmbledhur, sqaroi se, në kontratën e shitjes, nuk është shënuar sipërfaqja e shtesës, pasi kontrata e shitjes është bërë vetëm për sendet e regjistruara në ASHK (ish ZVRPP). Për shtesën është bërë deklaratë noteriale nga shitësi F. M., me nr. ** rep. dhe nr. ** kol., datë 14.12.2010, ku ka dhënë pëlqimin për vazhdimin e procedurave në emër të bashkëshortes Shpresjona Elmazi, pasi shtesa ka qenë pjesë përbërëse e cmimit të përgjithshëm të

shitjes së apartmentit. Lidhur me cmimin e blerjes prej 1.900.000 lekë, subjekti shpjegoi se kjo vlerë është vlere që kanë dakordësuar me shitësin, pasi apartamenti ndodhet në një pallat tre-katësh të vjetër dhe kjo ishte vlere reale e tij, pasi në atë kohë, nuk ka pas cmim reference detyruar për kontratën e blerjes. Shuma 1.900.000 lekë është paguar një pjesë para lidhjes së kontratës dhe shlyerja totale e saj është bërë pas lidhjes së kontratës.

4.8. Për bllokimin e kësaj prone për BKT, subjekti shpjegoi se ky apartament është lënë kolateral për kredinë e butë prej 5.424.000 lekë, që ka marrë vëllai me babain e tij, për blerjen e një banese si të pastrehë. Ky apartament është përdorur për banim nga subjekti dhe familja e tij deri në momentin që kanë nisur të banojnë në apartmentin e ri, në vitin 2018 (në rrugën "Dervish Hekali", trajtuar më lart). Nga viti 2019 ky apartament është dhënë me qira, ku është paguar edhe tatimi në burim.

4.9. Për konfirmimin e Raiffeisen Bank, subjekti shpjegoi se burimi financiar i shumës 1.700.000 lekë kanë qenë 1.200.000 lekë të depozituara nga xhaxhai i tij, Hasan Elmazi dhe 500.000 lekë kursimet e vet subjektit. Shuma 1.200.000 lekë e depozituar nga xhaxhai ka qenë një hua, që subjekti i'a kishte dhënë xhaxhait ndër vite, të cilën i'a ka kërkuar mbrapsht, kur bleu apartmentin. Shpjegoi se xhaxhai ka qenë me profesion ekonomist, i punësuar në një firmë peshkimi.

4.10. Për përdorimin e shumës 1.700.000 lekë, shpjegoi se një pjesë e ka përdorur për pagesën e këstit të parë të apartamentit dhe pjesën tjetër e ka bërë pjesë të likuiditeteve të familjes. Për shumën 1.000.000 lekë të konfirmuar në ProCredit Bank, shpjegoi se burimi financiar i saj ka qenë 700.000 lekë, hua e marrë nga shoqëria "Aulona-Pol" sh.p.k., hua të cilën e ka shlyer në vitin 2011, si dhe 300.000 lekë, hua nga shoku i tij, L. H., hua të cilën e ka shlyer në vitin 2008. Për përdorimin e shumës 1.000.000 lekë, shpjegoi se një pjesë e ka përdorur për pagesën e këstit të dytë të apartamentit, ndërsa pjesën tjetër e ka bërë pjesë të likuiditeteve të familjes.

4.11. Në këtë apartament subjekti dhe familja e tij kanë jetuar për periudhën 2007 - 2018. Lidhur me shpenzimet e mobilimit, subjekti shpjegoi se apartamenti është blerë i mobiluar dhe me kohë ka kryer zëvendësime të pajisjeve, por që nuk kanë pasur zë në buxhetin familjar, pasi janë zëvendësuar ndër vite.

4.12. Për banesat ku ka jetuar ndër vite, përpara se të blinte këtë apartament, subjekti shpjegoi se afërsisht, në periudhën maj 2000 - shtator 2005, ka jetuar me qira afër "Qytetit Studenti" në rrugën "Arben Broci". Dokument ligjor nuk disponon, pasi objekti ka qenë pa leje dhe në proces legalizimi dhe nuk kanë bërë kontratë, por marrëveshje verbale dhe pagesa e qirasë mujore ka qenë 6.000 lekë. Për një periudhë të shkurtër kohore, në vitin 2005, për 1 muaj, ka jetuar te "Komuna e Parisit" ku ka bërë edhe regjistrimin në gjendjen civile, në Njësinë Bashkiake nr.5. Qiraja për këtë muaj ka qenë 10.000 lekë. Më vonë, nga viti 2005, deri në vitin 2007, deri kur kanë blerë apartamentin, kanë banuar në një banese tjetër te "21 Dhjetori" dhe pagesa mujore ka qenë 10.000 lekë, por edhe për këtë banesë nuk disponon kontrate qiraje. Nga viti 2007, deri në vitin 2018, kur ka përfunduar së ndërtuari pallati i ri në rrugën

"Dervish Hekali", kanë jetuar te ky apartment, ndërsa nga fundi i vitit 2018, jetojnë në banesën në rrugën "Dervish Hekali" (trajtuar më lart).

Bashkëlidhur paraqiti:

- Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 03.10.2006, për pasurinë e llojit apartament me sip. 51,7 m², me nr. pasurie **, në emër të F. M. dhe Kartela e pasurisë.
- Kontratë kredie nr. ** rep., nr. ** kol., datë 13.08.2010, për kredi në shumën 5.424.000 lekë (për blerje apartamenti). Kredimarrës: S. dhe R. Elmazi. Kredidhënës: BKT. Dorëzanës: M., R., Ardit e Shpresjona Elmazi, si dhe A. dhe V. M. Sigurimi i kredisë bëhet nga hipotekimi i pasurive të paluajtshme: Apartament me sip. 51,7 m², me nr. pasurie ** Tiranë, regjistruar në emër të Shpresjona Elmazi. Gjithashtu në momentin e regjistrimit në ZRPP të shtesës së ndërtuar në pasurinë apartament, Shpresjona Elmazi duhet ta hipotekojë këtë në favor të BKT; Apartament me sip. 59 m², me nr. pasurie **, Tiranë, regjistruar në emër të A. M.
- Deklaratë noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë 08.03.2024, lëshuar nga administratori i shoqërisë "Aulona - Pol - 1" sh.p.k., V. M., i cili deklaron se në datën 13.11.2007, nga llogaritë e Aulona - Pol - 1 sh.p.k., i është dhënë hua pa interes shtetasit Ardit Elmazi shuma 700.000 lekë, shumë e cila është shlyer prej tij në vitin 2011.
- Kartela e llogarive të shoqërisë "Aulona - Pol - 1" (format Excel me vulën e shoqërisë), ku evidentohet se në datë 13.11.2007 është debituar llogaria e shoqërisë në ProCredit Bank, në shumën 700.000 lekë, me përshkrimin "Dhënie hua Ardit Elmazi" dhe në datë 05.12.2011 është kredituar Arka e shoqërisë në shumën 700.000 lekë, me përshkrimin "Kthim hua Ardit Elmazi" dhe Pasqyrat financiare të shoqërisë për periudhën 01.01.2007 - 31.12.2007.
- Deklaratë noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë 08.03.2024, lëshuar nga L. H., i cili deklaron, se në datë 16.11.2007, i ka dhënë hua Ardit Elmazit një shumë prej 300.000 lekë, pa interes.
- Vërtetim nr. ** prot., datë 12.03.2024, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë, Tiranë, ku vërteton se Nënkomisar L. H., është punonjës i Policisë së Shtetit prej datës 10.04.2006 e në vazhdim.
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, ku evidentohet se kreditimi i pagës, shtetasi L. H. për periudhën nga data 04.05.2006, deri në datën 16.11.2007 (kur ka dhënë huanë), ka përfituar në total 773.597 lekë.

4.13. Me inventarin e datës 16.04.2024, subjekti paraqiti:

- Deklaratë noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë 18.03.2024, lëshuar nga H. Elmazi, i cili deklaron se i ka kthyer nipit të tij, Ardit Elmazi, shumën 1.200.000 lekë, që i kishte marrë borxh, ndër vite, duke i'a kaluar në llogarinë e tij bankare në Raiffeisen Bank.
- Vërtetim i lëshuar nga Raiffeisen Bank, ku vërteton se në datë 24.08.2007, në llogarinë e Ardit Elmazi është bërë në depozitim në shumën 1.200.000 lekë, nga H. Elmazi.

4.14. Me inventarin e datës 19.04.2024, subjekti paraqiti:

- Kthim përgjigje nr. ** prot., datë 15.04.2024, nga ISSH, Sarandë, drejtuar H. Elmazit, ku i ka bashkëlidhur vendimet për caktimin e masës së pensionit, prej 13.541 lekë, nga

- data 07.01.2021 dhe rishikimin e tij në shumën 20.720 lekë, me vendimin e datës 11.01.2022.
- Librezë pune për H. Elmazi, për periudhën 1979 - 1996; 2003 - 2004 dhe 2018 - 2021 dhe dokumente nga ISSH për vjetërsinë në punë.
 - Diplomë studenti në emër të H. Elmazi, datë 20.06.1980, për kursin në Ekonomi Agrare.
 - Kontratë shitblerje pasurie e paluajtshme, nr. ** rep., nr. ** kol., datë 08.06.2006, për apartamentin me sip. 66,6 m², në rrugën "Ali Pashë Gucia", Tiranë, i shitur për cmimin 2.000.000 lekë.
 - Kontratë shitblerje pasurie e paluajtshme nr. ** rep., nr. ** kol., datë 26.09.2007, për apartamentin me sip. 33 m², në rrugën "Bardhyl", Tiranë, i shitur për cmimin 1.000.000 lekë.
 - Kontratë shitblerje pasurie e paluajtshme nr. ** rep., nr. ** kol., datë 13.11.2007, për bodrum me sip. 64 m², në rrugën "Bajram Curri", Tiranë, i shitur për cmimin 1.900.000 lekë. Kontratë shitblerje pasurie e paluajtshme nr. ** rep., nr. ** kol., datë 20.07.2006, për apartamentin me sip. 61,8 m², në rrugën "Barrikadave", Tiranë, i shitur për cmimin 1.000.000 lekë.
 - Fotografi të një pallati 3-kate, i cili në pamje duket një ndërtesë e vjetër dhe jo i mirëmbajtur.

4.15. Bazuar në deklarinimin e subjektit, sqarimet dhe dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar nga ILDKPKI, në mënyrë të përmbledhur, rezulton se: Në vitin 2007, b/shortja e subjektit, ka lidhur një kontratë shitblerje për një apartament me sip. 51,7 m², për shumën 1.900.000 lekë, cmim në të cilin ka qenë i përfshirë edhe blerja e një sipërfaqeje shtesë prej 25,55 m² (ndërtuar më parë nga shitësi). Përfshirja e shtesës në cmimin e blerjes së apartamentit, prej 1.900.000 lekë është pranuar nga palët me deklaratë noteriale në vitin 2010, kohë kur Shpresjona Elmazi ka aplikuar për ndryshimin e emrit në procedurat për legalizimin e shtesës nga shitësi, në emrin e saj. (cmimin e blerjes prej 1.900.000 lekë, subjekti deklaroi se e ka paguar një pjesë përpara lidhjes së kontratës dhe një pjesë pas lidhjes së saj. Si burim financiar për plotësimin e shumës 1.900.000 lekë ka përdorur tërheqjet që ka kryer në Raiffeisen Bank dhe ProCredit Bank në vitin 2007, që kanë pasur si burime kursimet e tij, një borxh të kthyer nga xhaxhai i tij, një hua e marrë nga shoqëria "Aulona Pol" dhe një hua e marrë nga shoku i tij L. H., hua të cilat i ka shlyer përkatësisht në vitet 2011 dhe 2008. Për apartamentin me sip. 51,7 m² dhe shtesën me sip. 25,55 m², në vitin 2022 ka dalë certifikata e pronësisë në emër të b/shortes, për apartament me sip. 75 m².

4.16. Në kthim përgjigjet nr. ** prot., datë 01.11.2024, subjekti ka sqaruar se borxhin prej 1.200.000 lekësh ja ka dhënë xhaxhait të tij për arsye familjare dhe 400 mijë lekë ja ka dhënë në vitin 2004 dhe pjesën tjetër në vitin 2006.

4.17. Gjithashtu subjekti në kthim përgjigjet sqaron, se pavarësisht se në deklaratën e pasurisë në lidhje me blerjen e apartamentit për shumën 1.900.000 lekë kam deklaruar si burim, kursimet familjare ndër vite dhe nuk kam përmendur kthimin e borxhit

1.200.000 lekë që ja kisha dhënë xhaxhait, kjo nuk ka patur qëllim fshehjen e këtij borxhi të dhënë dhe në asnjë moment qëllim fshehje pasurie, por thjesht harresë.

- 4.18. Referuar të dhënave të tregut të lirë të apartamenteve sipas EKB, kosto e shitjes lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi në qytetin e Tiranës, në vitin 2007 ka qenë 97.000 lekë/m², kosto kjo më e lartë se kosto e përlllogaritur për blerjen e apartamentit nga ana e b/shortes së subjektit, prej 25.333 lekë/m². Lidhur me cmimin e blerjes, subjekti ka shpjeguar se kjo ka ardhur, pasi apartamenti i blerë ndodhet në një pallat 3-katësh të vjetër dhe të amortizuar dhe kjo ka qenë vlera reale e tij.
- 4.19. Në këtë apartament subjekti ka banuar për periudhën 2007 - 2018, deri kur kanë nisur të banonte në apartamentin tjetër në rrugën "Dervish Hekali". Këtë apartament e kanë blerë të mobiluar dhe në vite kanë kryer zëvendesimin e pajisjeve.
- 4.20. ASHK konfirmon apartamentin dhe shtesën në rrugën "4 Dëshmorët", Tiranë të regjistruar në pronësi të Shpresjona Elmazi.
- 4.21. Për periudhën 2000 - 2007, kur subjekti dhe b/shortja, nuk kanë pasur apartament në pronësi, subjekti shpjegon se kanë jetuar me qira, ku sipas përlllogaritjes së deklarimeve të tij, shuma e shpenzuar në total ka qenë rreth 610.000 lekë.
- 4.22. Trupa Vlerësuese ka kërkuar subjektit sqarime nëse kjo shumë është shpenzim vjetor pasi rezulton të jetë shumë e ulët dhe jo në përputhje me cmimet e tregut të kohës. Në shpjegimet e tij subjekti ka theksuar se kjo shumë është në total, pasi unë kam jetuar në zonë rurale mbrapa qytetit student dhe me një cmim gjashtë mijë lekësh në muaj, si zonë me shtëpi që kyesisht merreshin me qera nga studentët dhe këto kanë qenë cmimet e kohës. Nga viti 2005 deri në 2007 kam paguar qera në shumën 10000 lekë në zona të ndryshme të Tiranës.
- ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion justifikues, lidhur me burimin financiar të shumës 1.900.000 lekë, përdorur pqr blerjen e apartamentit me sip. 75 m², në Rr. "4 Dëshmorët", Tiranë, shumë, që sipas deklaramit është paguar me dy këste, një pjesë përpara lidhjes së kontratës dhe një pjesë pas lidhjes së kontratës (pavarësisht përcaktimit në kontratë, ku është cituar se likuidimi i shumës 1.900.000 lekë është bërë para lidhjes së kontratës). Për burimin financiar të xhaxhait për shumën 1.200.000 lekë, përdorur për blerjen e apartamentit, për të cilin subjekti ka paraqitur vetëm dokumente nga punësimi i tij (jo financiare), është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1. e ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Cështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar.**
 - ✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me cmimin prej 1.900.000 lekë të blerjes së apartamentit në vitin 2007, i ulët krahasuar me referencën e cmimit të qytetit të Tiranës, se apartamenti i blerë ndodhet në një pallat të vjetër dhe të amortizuar dhe kjo ka qenë vlera reale e tij. Për të justifikuar vlerën reale të blerjes së këtij**

apartamenti nga ana e tij, në shumën 1.900.000 lekë, subjekti paraqiti fotografi nga pallati i amortizuar dhe katër kontrata shitblerje pasurie të paluajtshme të viteve 2006 dhe 2007, për apartamente dhe bodrum me një sipërfaqe 66,6 m², 33 m², 64 m² dhe 61 m², në disa zona të Tiranës, ku cmimi i shitjes së tyre ka qenë 1.000.000 lekë, deri në 2.000.000 lekë.

5. Llogari rrjedhëse bankare pranë Raiffeisen Bank, në emër të Ardit Elmazi, me numër llogarie **. Gjendja e llogarisë deri me datën 07.03.2023 është 2.553.067 lekë. Zotërimi 50%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga, dieta, shpërblime dhe nga qiraja e banesës.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

5.1.Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 12.09.2023, konfirmon se Ardit Elmazi, në datë 10.03.2023, ka pasur llogari page me gjendje 2.553.067 lekë.

- ✓ Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e Raiffeisen Bank.
- ✓ Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë me kursime familjare.

6. Llogari rrjedhëse bankare pranë Raiffeisen Bank, në emër të Ardit Elmazi, me numër llogarie **. Gjendja e llogarisë deri me datë 07.03.2023 është 4.114 euro. Zotërimi 50%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga qiraja e banesës në emër të b/shortes.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

6.1.Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 12.09.2023, konfirmon se Ardit Elmazi, në datë 10.03.2023, ka pasur llogari rrjedhëse, me gjendje 4.514 euro. Ndryshimi i gjendjes së llogarisë së deklaruar me atë të konfirmuar nga RFZ Bank, ka ndodhur si rezultat i paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe konkretisht; Gjendja e deklaruar nga subjekti, i përket datës 07.03.2024, ndërsa konfirmimi i bankës i përket datës 10.03.2023. Gjendje cash në shtëpi 2.000 euro. Burimi i krijimit: Shitja e makinës së b/shortes me datë 17.01.2022, sipas kontratës nr. ** rep., të noteres S. T., në shumën 6.500 euro. Zotërimi 50%.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Kontratë shitje automjeti nr. ** rep., nr. ** kol., datë 17.01.2022, për automjet Daimler Chrysler, me targa AA 398 SB. Shitës: Shpresjona Elmazi. Blerës: P. P. Cmimi: 6.500 euro.

6.2.DPSHTRR, me postën elektronike të datës 31.10.2023, konfirmon se Shpresjona Elmazi ka pasur në pronësi automjetin me targa AA 398 SB (AB 364 FO).

Bashkëlidhur:

- Kontratë shitje automjeti nr. ** rep., nr. ** kol., datë 28.07.2017, për automjet Daimler Chrysler. Blerës: Shpresjona Elmazi. Shitës: Artur Marashi. Cmimi: 6.500 euro.
- Kontratë shitje automjeti nr. ** rep., nr. ** kol., datë 17.01.2022, për automjet Daimler Chrysler, me targa AA 398 SB. Shitës: Shpresjona Elmazi. Blerës: P. P. Cmimi: 6.500 euro.

6.3.Me proces-verbalin e datës 04.03.2024, subjektit i'u kërkuan shpjegime dhe dokumente justifikuese për burimin financiar të përdorur për blerjen e automjetit, me targa AA 398 SB, në shumën 6.500 euro, si dhe shitjen e tij me një cmim të njëjtë me atë të blerjes, pas përdorimit të tij për 5 vite.

6.4.Me inventarin e datës 11.03.2024, subjekti paraqiti dokumente justifikuese dhe shpjegimet me shkrim, ku, në mënyrë të përmbledhur, sqaroi se, si burim financiar për blerjen e këtij automjeti kanë shërbyer kursimet ndër vite. Pëer sa i përket shitjes së këtij automjeti, shpjegoi se vlera e tregut për këto makina ka mbetur pothuajse e pa ndryshuar, plus që makina ka qenë në gjendje shumë të mirë teknike.

Bashkëlidhur:

- Njoftim shitje automjetesh (4 publikime online), që sipas subjektit janë të të njëjtit lloj automjeti në të njëjtën periudhë, ku evidentohet se cmimi i shitjes për dy automjete është 7.300 euro, 8.300 euro, 7.500 euro dhe 9.000 euro.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur, shpjegimet e dhëna dhe përgjigjen e DPSHTRR. Subjekti shpjegoi se si burim financiar për blerjen e automjetit me targa AA 398 SB, kanë shërbyer kursimet ndër vite.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë me kursime familjare.**
- ✓ **Gjithashtu shpjegoi dhe paraqiti dokumente edhe për shitjen e këtij mjeti, ku të ardhurat e përfituara prej tij kanë shërbyer për krijimin e gjendjes cash të deklaruar prej 2.000 euro.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Maj 2000 - Mars 2002, komandant grupi reparti special "Brisku", të ardhurat janë nga paga, shpërblime, orë shtesë, dieta, etj., në lidhje me funksionin. Në bazë të vërtetimit të marrë nga institucioni përkatës (RESI, nr. ** prot., datë 13.04.2018). Shuma 985.752 lekë.
- Mars 2002 - Tetor 2004, specialist i Zyrës Rajonale të Luftës Kundër Trafiqueve të Paligjshme, Tiranë. Të ardhurat janë paga, shpërblime, orë shtesë, dieta, etj., në lidhje me funksionin, sipas vërtetimit përkatës të lëshuar nga Dretoria Vendore e Policisë Tiranë nr. ** prot., datë 16.04.2018. Shuma 954.964 lekë.
- Tetor 2004 - Prill 2005, shef seksioni i luftës kundër trafiqueve, Lezhë. Të ardhurat janë paga, shpërblime, orë shtesë, dieta, etj., në lidhje me funksionin, sipas vërtetimit përkatës të lëshuar nga institucioni. Shuma 144.704 lekë.

- Maj 2005 - 30.04.2018, detyra të ndryshme, sipas urdhërave përkatës të pasqyruar në shtojcën nr. 3. Të ardhurat janë paga, shpërblime, orë shtesë, dieta, etj., në lidhje me funksionet e kaluara nëpërmjet sistemit bankar Raiffeisen Bank dhe Tirana Bank. Shuma 11.936.937 lekë.
- Maj 2018 - 07.03.2023, shef i Komisarariatit të Policisë nr. 3, Tiranë, shef i Komisarariatit të Policisë nr. 6, Kombinat - Tiranë, shef i Komisarariatit të Policisë - Kolonjë, specialist në Sektorin Kundër Krimeve ndaj Personit në DPP Shtetit, Zv/Drejtor për Hetimin e Krimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë. Të ardhurat janë nga paga, shpërblime, orë shtesë, dieta, etj. Në lidhje me funksionet e mësipërme, të kaluara nëpërmjet sistemit bankar Raiffeisen Bank. Shuma 5.215.763 lekë.
- Përfitimi financiar si arbitër në Federatën Shqiptare të Boksit, nga viti 2000 deri në vitin 2012. Në bazë të vërtetimit nr. ** prot., datë 27.04.2018. Të ardhurat e mia nga ky institucion janë me përafërsi rreth 1.400.000 lekë, pasi Federata nuk ka nxjerrë një shifër të saktë për të ardhurat e përfituara gjatë kësaj periudhë si arbitër boksi pranë kësaj federate. Shuma 1.400.000 lekë.
- Të ardhura nga qiraja e banesës në emër të b/shortes, për periudhën nëntor 2019 - shkurt 2023, në shumën 1.558.539 lekë. Të dhëna të marra nga sistemi i tatimeve për të cilat janë paguar edhe tatimet përkatëse (E-Filing).
Bashkëlidhur deklaratës:
- Vërtetim nr. ** prot., datë 13.04.2018, lëshuar nga Reparti Special RESI, i cili vërteton se Ardit Elmazi, për periudhën maj 2000 - mars 2002, ka përfituar të ardhura në shumën 985.752 lekë.
- Vërtetim nr. ** prot, datë 16.04.2018, DVP Tiranë, i cili vërteton se Ardit Elmazi, për periudhën 20.03.2002 - 22.10.2004, ka përfituar të ardhura në shumën 954.964 lekë.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare, lëshuar nga DVP Lezhë, i cili vërteton se Ardit Elmazi, për periudhën tetor 2004 - prill 2005, ka përfituar të ardhura në shumën 226.795 lekë.
- Vërtetim lëshuar nga DVP Tiranë, i cili vërteton se Ardit Elmazi, për periudhën janar 2016 - maj 2021, ka përfituar të ardhura në shumën 5.553.320 lekë.
- Vërtetim lëshuar nga DPP, i cili vërteton se Ardit Elmazi, për periudhën 07.11.2021 - 31.12.2022, ka përfituar të ardhura në shumën 1.235.527 lekë.
- Vërtetim lëshuar nga DVP Korçë, i cili vërteton se Ardit Elmazi, për periudhën 10.05.2021 - 08.11.2021 dhe 01.01.2023 - 28.02.2023, ka përfituar të ardhura në shumën 758.301 lekë.
- Vërtetim nr. ** prot., datë 27.04.2018, lëshuar nga Federata Shqiptare e Boksit, ku vërteton se Ardit Elmazi ka qenë gjyqtar boksi për periudhën 2000 - 2012. Duke mos pasur mundësi për të përcaktuar me saktësi të ardhurat e tij gjatë kësaj periudhe për mungesë dokumentacioni, jep një informacion mbi periudhat e eventeve sportive dhe pagesën e çdo gjyqtari që është mesatarisht 144.000 lekë në vit.
- Kontratë qiraje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 09.10.2019, për apartamentin me sip. 75 m², me nr. pasurie **, në rrugën "4 Dëshmorët", Tiranë. Qiradhënës: Shpresjona Elmazi. Qiramarrës: V. M. Qiraja 300 euro, e cila do të paguhet në datën 15 deri 17 të cdo muaji. Afati: 2 + 3 vjet, duke nisur nga data 09.10.2019, me të drejtë rinovimi. Të gjitha detyrimet dhe taksat në lidhje me vlerën e qirasë, merren përsipër të paguhet nga qiradhënësi.

- Kontratë qiraje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 30.12.2020, për apartmentin me sip. 75 m2, me nr. pasurie **, në rrugën "4 Dëshmorët", Tiranë. Qiradhënës: Shpresjona Elmazi. Qiramarrës: L. B. Qiraja 350.000 lekë (35.000 lekë/muaj, e konfirmuar në RFZ Bank), e cila do të paguhet në datën 15 deri 17 të çdo muaji. Afati: 2 vjet, duke nisur nga data 01.01.2021, me të drejtë rinovimi. Të gjitha detyrimet dhe taksat në lidhje me vlerën e qirasë merren përsipër të paguhen nga qiradhënësi.
- Kontratë qiraje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 19.12.2022, për apartamentin me sip. 75 m2, me nr. pasurie **, në rrugën "4 Dëshmorët", Tiranë. Qiradhënës: Shpresjona Elmazi. Qiramarrës: M. S. Qiraja 400 euro në muaj. Afati: 09.01.2023 - 09.01.2024. Qiramarrësi merr përsipër të paguajë tatimin mbi fitimin.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

1. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. **2 prot., datë 12.09.2023, konfirmon se Ardit Elmazi, për periudhën 03.05.2005 - 23.12.2010 dhe 05.01.2012 - 10.03.2023, ka përfituar të ardhura nga pagat, dieta, etj, në shumën 16.446.657 lekë. Gjithashtu konfirmon se për periudhën 07.01.2021 - 11.08.2022, i janë kredituar në llogari pagesa qiraje në shumën 635.010 lekë, ndërsa për periudhën 15.11.2019 - 18.09.2020 dhe 15.09.2022 - 10.03.2023, i janë kredituar pagesa qiraje, në shumën 5.490 euro.
2. Tirana Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 10.09.2023, konfirmon se Ardit Elmazi, për periudhën 06.01.2011 - 13.12.2011, ka përfituar të ardhura nga pagat, dieta, et., në shumën 971.102 lekë.
3. DRT Tiranë, me shkresën nr. ** prot., datë 25.09.2023 dhe nr. ** prot., datë 21.09.2023, konfirmon se Shpresjona Elmazi është regjistruar më datë 20.11.2019, si Individ Privat, për përgjegjësinë tatimore Tatim i Mbajtur në Burim. Nga ana e kësaj shtetaseje është kryer deklarimi për periudhat nëntor 2019 - deri mars 2023, si më poshtë:

Periudha tatimore	Pagesa qiraje	Tatim qiraje
2019	73.671	11.051
2020	447.018	67.054
2021	420.000	63.000
2022	464.366	69.653
2023	138.484	20.772

4. ISSH, me shkresën nr. ** prot., datë 15.09.2023, konfirmon se Ardit Elmazi, për periudhën janar 2012 - mars 2023, rezulton i punësuar/ka përfituar të ardhura pranë institucioneve: Komisariati i Policisë Shkodër; Drejtoria e Policisë; Drejtoria e Policisë së Qarkut Fier; Drejtoria e Policisë së Qarkut Korçë; dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.
5. Me proces-verbalin e datës 04.03.2024, subjektit i'u kërkuan shpjegime për të ardhurat e deklaruara nga Federata Shqiptare e Boksit.

6. Me inventarin e datës 11.03.2024, subjekti paraqiti shpjegimet me shkrim, ku në mënyrë të përmbledhur sqaroi se të ardhurat e përfituara nga FSHB janë marrë në cash në formë honorari, në bordero dhe kanë qenë jashtë sistemit bankar. Tatimi për këto të ardhura është paguar nga FSHB, si institucion shtetëror. Subjekti paraqiti edhe dokumente për pagesën e tatimit për qiranë e apartamentit për periudhën 19.12.2019 - 13.2.2024 (ku për periudhën deri në datë 10.03.2023, evidentohet se janë paguar gjithsej 223.214 lekë).
7. Të ardhurat neto të subjektit nga pagat, dieta, shpërblime, etj, për periudhën maj 2000 - mars 2023, janë në shumën rreth 19.307.700 lekë, si dhe 1.440.000 lekë i ka përfituar si arbitër boksi, pranë Federatës Shqiptare të Boksit.
8. Të ardhurat neto nga qiradhënia e apartamentit, në rrugën "4 Dëshmorët", Tiranë, për periudhën 2019 - 2023, rezultojnë rreth 1.312.000 lekë. Pagesa e tatimit në burim, konfirmohet nga DRT Tiranë.
9. Të ardhura neto nga interest bankarë rezultojnë rreth 452.835 lekë.
10. Të ardhura neto nga investimi në tituj rezultojnë rreth 161.000 lekë.

DETYRIME FINANCIARE

1. **Huaja 2.500.000 lekë e marrë tek "Aulona Pol" sh.p.k., për blerjen e shtëpisë së banimit me sip. 176,9 m2, kontratë porosie nr. ** kol., nr. ** rep., lidhur me shoqërinë "Rinia 04" sh.p.k., me datën 06.03.2015. Kjo hua është marrë me kontratë nr. ** rep., nr. ** kol., datë 02.03.2015, "Kontratë huaje" e cila do t'i kthehet në momentin e shitjes së pronës në fjalë sipas kontratës. Shuma e detyrimit: 2.500.000 lekë.**

Trajtuar më lart.

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur - Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.

Pagesa për konsumin e energjisë elektrike, në emër të Ardit Elmazit, për periudhën shkurt 2022 - mars 2023, është 107.365 lekë. Pagesa për konsumin e energjisë elektrike, në emër të Shpresjona Elmazit, për periudhën shkurt 2022 - mars 2023, është 51.893 lekë. Kjo shumë është paguar nga qiramarrësit. Pagesa për konsumin e ujit, në emër të Ardit Elmazit, për periudhën mars 2022 - mars 2023, është 29.672 lekë. Pagesa për konsumin e ujit, në emër të Shpresjona Elmazit, për periudhën mars 2022 - mars 2023, është 16.869 lekë. Kjo shumë është paguar nga qiramarrësit. Pagesat për telefonat për periudhën janar 2022 - janar 2023, janë në shumën rreth 28.500 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, për llogari në emër të Ardit Elmazit, ku evidentohet se për periudhën janar 2022 - dhjetor 2022 janë kryer pagesat e energjisë elektrike, ujit dhe telefonisë celulare.
- Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, për llogari në emër të Shpresjona Elmazit, ku evidentohet se për periudhën prill 2022 - shkurt 2023, janë kryer pagesat e energjisë elektrike dhe ujit.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

1. FSHU, me shkresën nr. ** prot, datë 21.09.2023, konfirmon se me gjeneralitetet Ardit Selman Elmazi, identifikohet / abonent me kontratën e furnizimit nr.TR2Axxx, kontratë familjare me adresë: rruga "Dervish Hekali", Tiranë. Për periudhën janar - dhjetor 2022, janë kryer pagesa për energjinë, në shumën 99.023 lekë. Ndërsa me gjeneralitetet Shpresjona Faik Elmazi, identifikohet 1 abonent me kontratën e furnizimit nr. TR2Pxxx, kontratë familjare me adresë: rruga "4 Dëshmorët", Tiranë. Për periudhën janar - dhjetor 2022, janë kryer pagesa për energjinë në shumën 40.268 lekë.
2. UKT, me shkresën nr. ** prot., datë 29.09.2023, konfirmon se me emrin e Ardit Elmazi, rezulton kontrata nr. **, për objektin me adresë: rruga "Dervish Hekali", me statusin aktiv, ku për vitin 2022 janë paguar 29.500 lekë dhe me emrin e Shpresjona Elmazi, rezulton kontrata nr. **, për objektin me adresë: rruga "4 Dëshmorët", me statusin aktiv, ku për vitin 2022 janë paguar 15.244 lekë. Bashkëlidhur dokumentacioni pronësor i apartamenteve.
3. Katërbëdhjetë Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës - Kanalizime, me shkresat nr. **, ** prot., nuk konfirmojnë kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
4. Vodafone sha, me shkresën nr. ** prot., datë 02.02.2024, konfirmon se Ardit Elmazi për vitin 2022: për numrin e celularit +35569xxx, ka shpenzuar 17.750 lekë; për numrin e celularit +35569xxx, ka shpenzuar 7.500 lekë; dhe për numrin e celularit +35569xxx, ka shpenzuar 6.000 lekë.
5. One Albania sha, me shkresën nr. ** prot., datë 11.10.2023, konfirmon se në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të, nuk rezultojnë të ketë numra të regjistruar në shërbimin e telefonisë mobile, telefonisë fikse/internetit në rrjetin One gjatë vitit 2022.
6. Tring sha, me shkresën nr. ** prot., datë 21.09.2023, konfirmon se subjekti dhe personat e lidhur me të, nuk kanë nënshkruar kontratë me këtë shoqëri për periudhën e kërkuar.
7. ABISSNET sha, me shkresën nr. ** prot, datë 09.02.2024, nuk konfirmon të ketë lidhur kontratë me subjektin ose personat e lidhur me të.

8. DIGICOM sha, me shkresën nr. ** prot., datë 18.09.2023, nuk konfirmon që subjekti ose personat e lidhur me të, të kenë marrë shërbime interneti nga kjo shoqëri.
9. Shpenzimet për energji elektrike, ujë, internet dhe telefoni, për sa deklaruar dhe dokumentuar, për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, kanë qenë në shumën rreth 215.000 lekë.

Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara - Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022.

- Selanik - Greqi, nga data 04.02.2023, deri në datë 06.02.2023, shpenzime udhëtime, fjetje, ushqim rreth 320 euro.
- Itali, nga data 20.11.2022, deri më datë 24.11.2022, për vizitë te djali i tezes E. G. Shpenzime vetëm për udhëtimin afërsisht 200 euro. Shpenzimet janë përballuar nga pritisësi, E. G.
- Angli, nga data 29.04.2022, deri në datë 04.05.2022, vizitë familjarisht te vajza e tezes në Londër, R. G. Shpenzime për vizat dhe për udhëtimin afërsisht 2.800 euro. Shpenzimet janë përballuar nga pritisësja, M. G.
- Shpresjona Elmazi, vizitë te motra e saj, O. B., ne Bilbao, Spanjë, nga data 17.02.2022 - 20.02.2022. Shpenzimet janë përballuar nga motra e saj O. B.
- Klea Elmazi, vizitë me tezen e saj, O. B., në Jordani, nga data 22.12.2022 - 30.12.2022. Shpenzimet janë përballuar nga teza e saj O. B.
- Klea Elmazi, vizitë me shoqen e saj, L. V., në Barcelonë, me rastin e ditëlindjes së Livias, nga data 10.02.2022 - 12.02.2022. Shpenzime të përballuara nga shoqja e saj L., pasi ka qenë e ftuar nga kjo e fundit.
- Klea Elmazi, vizitë te vajza e tezes sime në Londër, R. G. Shpenzime për udhëtimin afërsisht 250 Paund. Shpenzimet janë përballuar nga pritisësja, M.G.
- Itali, nga data 06.06.2021, deri me datën 09.06.2021. Shpenzime për udhëtim, fjetje dhe ushqim 700 euro.
- Itali, nga data 07.01.2020, deri më datën 10.01.2021, vizitë te vajza e tezes B. G. Shpenzime për udhëtim, 200 euro, fjetja dhe ushqimi janë përballuar nga vajza e tezes, B.

10. Me proces-verbalin e datës 04.03.2024, subjektit i'u kërkuan shpjegime dhe dokumente justifikuese për shpenzimet e deklaruara.

11. Me inventarin e datës 11.03.2024, subjekti paraqiti dokumente justifikuese dhe shpjegimet me shkrim, ku, në mënyrë të përmbledhur, sqaroi se, vlera e shpenzuar për udhëtimet jashtë vendit ka qenë vetëm vlera e biletave të udhëtimit, si dhe pagesat për vizat angleze, në total prej rreth 3.700 euro dhe 250 pound, në tre vite, nga 01.01.2020 - 31.12.2022. Shpenzimet e tjera janë mbuluar nga kushërinjtë që kanë qenë pritisës. Subjekti ka bashkëlidhur edhe disa dokumente për personat që kanë përballuar shpenzimet.

Bashkëlidhur:

- Të dhëna nga sistemi TIMS, për Ardit Elmazi, për periudhën 2004 - 2023.

- Të dhëna nga sistemi TIMS, për Shpresjona Elmazi, për periudhën 2005 - 2024.
- Të dhëna nga sistemi TIMS, për Aldo Elmazi, për periudhën 2012 - 2024.
- Te dhëna nga sistemi TIMS, për Klea Elmazi, për periudhën 2013 - 2023.
- Të dhëna nga sistemi TIMS, për Dion Elmazi, për periudhën 2015 – 2023.
- Leje qëndrimi për në Finlandë për shtetasen O. B.
- Leje qëndrimi për në Spanjë për shtetasen O. B.
- Dokumentacion qëndrimi (në gjuhën spanjolle), për O. B., lëshuar nga Ministria e Brendshme, Spanjë.
- Marrëveshje pune (në gjuhën angleze) datë 15.02.2023, lidhur midis O. B. dhe Succes Clinic Only, Finland.
- Marrëveshje për pjesëmarrjen në programin "LEAD Albania", datë 04.10.2018, lidhur mes O. B., Ministrisë së Shëndetësisë dhe fondacionit AADF.
- Marrëveshje për modifikim kontrate (në gjuhën spanjolle), datë 11.11.2019, lidhur mes O. B. dhe Universitetit Deusto, Spanjë.
- Kartë identiteti italiane, për shtetasin E. G.
- Dokument të ardhurash (në gjuhën italiane), për shtetasin E. G., për muajin janar 2024, në shumën neto 2.371 euro.
- Leje qëndrimi për në Itali për shtetasen B. L.
- Dokument në gjuhën italiane, datë 01.03.2024, për marrëdhëniet e punësimit të shtetasen B. L. me punëdhënësin, shoqërinë "Ladisa" s.r.l.

12. Me inventarin e datës 16.04.2024, subjekti paraqiti:

- E-mail, datë 12.04.2024, dërguar nga adresa e postës elektronike: **@deusto.es, në adresën shpresjona@hotmail.com, ku O. B. deklaroi se, nga data 17.02.2022 deri më datë 20.02.2022, motra e saj Shpresjona Elmazi, ka qenë e ftuar në Spanjë dhe shpenzimet e udhëtimit janë përballuar nga O. B., gjithashtu deklaroi se edhe mbesa, Klea Elmazi ka qenë e ftuar prej saj për një udhëtim në Jordani, nga data 22.12.2022 deri në datë 30.12.2022 dhe shpenzimet janë përballuar po nga ajo.
- E-mail, datë 13.04.2024, dërguar nga adresa e postës elektronike: **@gmail.com, në adresën shpresjona@hotmail.com, ku K. G. deklaroi se, kushëriri i gruas së tij, Ardit Elmazi, nga data 29.04.2022, deri më datë 04.05.2022 ka qenë për vizitë familjare tek ai në Londër dhe shpenzimet janë përballuar nga familja e tij.
- E-mail, datë 12.04.2024, dërguar nga adresa e postës elektronike: **@gmail.com, në adresën shpresjona@hotmail.com, ku E. G. deklaroi se, kushëriri i tij, Ardit Elmazi, nga data 20.11.2022, deri më datë 24.11.2022 ka qenë për vizitë te ai në Itali dhe shpenzimet janë përballuar prej tij.
- Statement bankar nga Revolut (në gjuhën greke), për llogari në emër të K. G. (me adresë në Londër), ku evidentohet se gjatë vitit 2022, i janë kredituar pagesa në shumën 5.674 GBP.
- Statement i pagës mujore për K. G., datë 05.04.2022, ku evidentohet se ka përfituar të ardhura neto në shumën 2.505 (GBP).
- Kartë rezidenti për në Mbretërinë e Bashkuar, për M. G. Shpenzimet për udhëtimet jashtë vendit, për sa deklaruar dhe dokumentuar, për periudhën 01.01.2020 - 31.12.2022, kanë qenë në shumën rreth 3.700 euro dhe 250 GBP, konvertuar rreth 546.058 lekë.

13. Për arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit të Verësimit.
14. Shpenzime arsimimi në shkollën 9-vjeçare dhe parashkollor për fëmijët Klea, Aldo dhe Dion Elmazi, për periudhën 2014 - 2016, në shkollën 9-vjeçare jo-publike "Albanët", Tiranë. Sipas vërtetimit të lëshuar nga shkolla, nr. ** prot., datë 18.04.2018, shuma 163.800 lekë.
15. Shpenzime arsimimi në Fakultetin Ekonomik shtetëror, për periudhën 2019 - 2022, e djalit tim, Aldo Elmazi, pagesa e universitetit 35.000 lekë.
16. Shpenzime arsimimi në Fakultetin e Drejtësisë, për periudhën 2022 - 2023, e vajzës sime Klea Elmazi, pagesa e universitetit 20.000 lekë.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nr. *8 prot., datë 18.04.2018, lëshuar nga shkolla jo-publike "Albanët", ku vërtetohet se nxënësit Klea dhe Aldo Elmazi kanë frekuentuar shkollën për vitet akademike 2014 - 2015 dhe 2015 - 2016 dhe pagesa për këto dy vite ka qenë në shumën 163.800 lekë.
17. Me proces-verbalin e datës 04.03.2024, subjektit i`u kërkuan shpjegime dhe dokumente justifikuese për shpenzimet universitare të deklaruara për fëmijët Aldo dhe Klea Elmazi.
 18. Me inventarin e datës 11.03.2024, subjekti paraqiti shpjegimet me shkrim, ku, në mënyrë të përmblodhur, sqaroi se, keto shpenzime janë tarifa e shkollimit në fakultetet përkatëse për fëmijët. Dokumentet justifikuese për këto shpenzime, nisur nga koha e shkurtër, nuk kanë pasur mundësi t`i marrin, por shumat e shpenzuara janë referuar tarifave publike të universiteteve publike.
 19. Shpenzimet për arsimimin e fëmijëve, për sa deklaruar dhe dokumentuar, për periudhën në fjalë kanë qenë në shumën rreth 219.000 lekë.

DEKLARIMI I B/SHORTES - SHPRESJONA ELMAZI

DEKLARIMI I PASURIVE

1. Shtëpi banimi me sip. 75 m², me hipotekë, në emër të Spresjona Elmazi, me adresë: Rr."4 Dëshmorët", pallati **, ap. nr. **, Tiranë. Me kontratë shitblerje apartamenti nr. ** rep., datë 28.09.2007, midis shitësit F. M. dhe blerësit Shpresjona Elmazi, në shumën 1.900.000 lekë, nga kursimet familjare ndër vite të miat dhe b/shortit. Zotërimi 50%.

2. Shtëpi banimi me sip. 147,40 m² me hipotekë, në zk. 8370, me nr. pasurie **, me adresë: Rr. "Dervish Hekali", pallati "Rinia 04", kati 4, ap. 11, Njësia Bashkiake nr. 8, Tiranë, me kontratë porosie nr. ** kol., nr. ** rep., e lidhur me shoqërinë "Rinia 04" sh.p.k., me datën 06.03.2015, Vlera 7.000.000 lekë. Zotërimi 50%.
3. Garazh me sip. 15 m², në zk, 8370, me nr, pasurie **, me kontrate porosie nr. ** kol, nr. ** rep., e lidhur me shoqërinë "Rinia 04" sh.p.k., në datën 06.03.2015. Vlera 700.000 lekë. Zotërimi 50%. Burimi i krijimit për të dy pasuritë e mësipërme: Kursime familjare ndër vite, huaja 2.500.000 lekë, e marrë tek Aulona - Pol sh.p.k., si dhe 2.500.000 lekë dhuruar nga babai F. B., më datë 03.03.2015.

Trajtuar më lart.

4. Llogari rrjedhëse në Credins Bank, në shumën 683.468 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga paga si mësuese e gjuhës gjermane në Shkollën e Mesme Teknike Ekonomike, Tiranë, Gjumnazi Sami Frashëri, Tiranë, si dhe drejtoreshë në gjumnazin "Ismail Qemali" Tiranë. Zotërimi 50%.
Bashkëlidhur deklaratës:
 - Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, për llogari në emër të Shpresjona Elmazi, ku gjendja në datë 28.02.2023, është në vlerën 683.468 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

- 4.1. Credins Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 08.10.2023, konfirmon se Shpresjona Elmazi, në datë 10.03.2023, ka llogari page me gjendje 726.680 lekë.
 - 4.2. B/shortja ka deklaruar dhe ka paraqitur dokumente për gjendjen e llogarisë në datën 28.02.2023, në vlerën 683.468 lekë, ndërsa Credins Bank, konfirmon gjendjen në datën e dorëzimit të deklaratës 10.03.2023, në vlerën 726.680 lekë.
- ✓ Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë me kursime familjare.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Të ardhurat nga pagat si mësuese në shkollën "Teknike Ekonomike", nga shtator 2004 - prill 2019. Shuma 6.518.791 lekë.
 - Të ardhurat nga pagat si nëndrejtor në shkollën "Sami Frashëri", nga maj 2019 - maj 2022. Shuma 2.396.769 lekë.
 - Të ardhurat nga pagat si drejtor në shkollën "Ismail Qemali" nga qershor 2022, deri tani. Shuma 609.434 lekë.
 - Përkthyes e licencuar pranë Ministrisë së Drejtësisë (pagesa bëhet sipas udhëzimit nr.3165, datë 12.05.2004 të Ministrisë së Drejtësisë). Shuma 26.820 lekë.
- Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Credins Bank, për llogari në emër të Shpresjona Elmazi për periudhën 31.12.2017 - 28.02.2023, ku evidentohen të ardhurat nga punësimi.
- Vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, për Shpresjona Elmazi, për periudhën maj 2019 - dhjetor 2022.
- Vërtetim nr. 295 prot., datë 27.02.2023, lëshuar nga Shkolla e Mesme Profesionale Teknike Ekonomike, Tiranë, që vërteton se Shpresjona Elmazi, për periudhën 01.01.2018 - 28.02.2018, ka marrë pagë neto në shumën 100.867 lekë, ndërsa për periudhën mars 2018 - 01.05.2019, ka qenë me raport mjekësor, leje lindje.
- Vërtetim nr. 492 prot., datë 20.04.2018, lëshuar nga Shkolla e Mesme Profesionale Teknike Ekonomike, Tiranë, ku vërteton se Shpresjona Elmazi, për periudhën 16.09.2004 - 31.03.2005, ka marrë pagë neto në shumën 105.552 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

1. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 12.09.2023, konfirmon se Shpresjona Elmazi, për periudhën 04.04.2005 - 03.04.2014, ka përfituar të ardhura nga pagat, shpërblimet dhe leja e lindjes, në shumën 3.543.492 lekë.
2. Credins Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 09.10.2023, konfirmon se Shpresjona Elmazi, për periudhën 06.05.2014 - 10.03.2023, ka përfituar të ardhura nga pagat, shpërblimet dhe leja e lindjes, në shumën 5.868.925 lekë.
3. ISSH, me shkresën nr. ** prot., datë 15.09.2023, konfirmon se Shpresjona Elmazi, për periudhën janar 2012 - mars 2023, rezulton i punësuar/ka përfituar të ardhura pranë institucioneve: Shkolla e Mesme Teknike Ekonomike dhe Drejtoria Arsimore Qytet.
4. Të ardhurat neto të b/shortes nga pagat, shpërblimet, leja e lindjes, etj, për periudhën shtator 2004 - mars 2023, janë në shumën rreth 9.367.625 lekë.

DEKLARIMI I DJALIT - ALDO ELMAZI

DEKLARIMI I PASURIVE

1. **Llogari personale në Lek, ne Raiffeisen Bank, në vlerën 630.650 leke. Zotërimi 100%.**
2. **Llogari personale ne Euro, ne Raiffeisen Bank, ne vlerën 10.718 euro. Zotërimi 100%.**

Burimi i Krijimit: Të ardhura nga biznesi me NIPT M265172020.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, për llogari në emër të Aldo Elmazi, ku gjendja në datë 22.02.2023, është në vlerën 630.650 lekë.
- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, për llogari në emër të Aldo Elmazi, ku gjendja në datë 08.03.2023, është në vlerën 10.718 euro.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

1-2.1. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 12.09.2023, konfirmon se Aldo Elmazi:

- Në datën 27.01.2023, në llogarinë e tij në monedhën Lek, ka derdhur një shumë prej 1.130.700 lekë, me përshkrimin "të ardhura nga biznesi". Nga kjo llogari, në datë 22.03.2022, ka transferuar një shumë prej 500.050 lekë, në llogarinë e "Aldo Emlazi PF", me përshkrimin "kalim fondesh për pagesa". Gjendja në këtë llogari në datë 10.03.2023 ka qenë në vlerën 630.650 lekë.
- Në datë 27.01.2023, në llogarinë e tij në monedhën Euro, ka derdhur një shumë prej 10.945 euro. Gjendja në këtë llogari, në datë 10.03.2023 ka qenë në vlerën 10.718 euro.

1-2.2. QKB online, konfirmon të regjistruar PF Aldo Elmazi, me datë 17.03.2022, me NIPT M265172022, me fushë veprimtarie "Bar-Restorant, shërbim katering". Adresa e ushtrimit të aktivitetit: Pasuria nr. **, zk. 1952, Llaman, Himarë.

1-2.3. DRT Vlorë, me shkresën nr. ** prot., datë 20.09.2023, konfirmon se Aldo Elmazi, i regjistruar me datë 17.03.2022, me NIPT M26517202Q, për vitin 2022, ka pasur të ardhura në shumën 12.665.021 lekë, shpenzime 9.239.936 lekë dhe fitim në shumën 3.425.085 lekë.

1-2.4. Subjektit i është kërkuar nga ana e Trupës të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues në lidhje me lejen e shfrytëzimit të plazhit, i cili në kthim përgjigjet e tij nr. ** prot., datë 01.11.2024, ka vënë në dispozicion të Trupës Vlerësuese:

- Kontratën për përdorimin e hapësirës së plazhit nr. ** prot., datë 22.07.2021, për afat 5 vjet, lidhur midis Agjencisë Kombëtare të Bregdetit, Bashkisë himarë dhe subjektit A. M.
- Procesverbal mbi përdoimin e hapësirës përkatëse të plazhit Llaman.
- Planvendosje të stacionit të plazhit të miratuar.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank, QKB online dhe DRT Vlorë.**
- ✓ **Ushtrimi i aktivitetit të biznesit është kryer konform ligjeve dhe rregullave në fuqi.**
- ✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë.**

3. Llogari biznesi në Lek, në Raiffeisen Bank, në vlerën 185.311 lekë. Zotërimi 100%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga biznesi me NIPT M26517202Q.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, në emër të PF Aldo Elmazi, ku gjendja në datë 28.02.2023, është në vlerën 185.311 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

3.1. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot, datë 12.09.2023, nuk konfirmon të dhëna për llogaritë e PF Ardit Elmazi.

3.2.QKB online, konfirmon të regjistruar PF Aldo Elmazi, me datë 17.03.2022, me NIPT M26517202Q, me fushë veprimtarie "Bar-Restorant, shërbim katering". Adresa e ushtrimit të aktivitetit: Pasuria nr **, zk. 1952, Llaman, Himarë.

3.3.DRT Vlorë, me shkresën nr. ** prot., datë 20.09.2023, konfirmon se Aldo Elmazi, i regjistruar në datë 17.03.2022, me NIPT M265172020, për vitin 2022, ka pasur të ardhura në shumën 12.665.021 lekë, shpenzime 9.239.936 lekë dhe fitim në shumën 3.425.085 lekë.

✓ **Konfirmohet deklarimi me përgjigjen e QKB online dhe DRT Vlorë. Raiffeisen Bank, nuk e konfirmon llogarinë e deklaruar, e cila sipas dokumentacionit të paraqitur i përket personit fizik "Aldo Elmazi".**

4. Llogari personale në Lek në Union Bank, në vlerën 48.814 lekë. Zotërimi 100%. Burimi i krijimit: Të ardhura nga pagat si futbollist te klubi i futbollit KF Laçi për vitet 2019 - 2021.

4.1. Union Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 04.10.2023, konfirmon se Aldo Elmazi në datë 10.03.2023, ka llogari rrjedhëse me gjendje 68.814 lekë. Djali i subjektit ka deklaruar gjendjen e llogarisë në vlerën 48.814 lekë, ndërsa Union Bank, konfirmon gjendjen në datën e dorëzimit të deklaratës 10.03.2023, në vlerën 68.814 lekë.

✓ **Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë me kursime familjare.**

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Llogari Kid në Raiffeisen Bank, në vlerën 767.000 lekë. Burimi i krijimit: Të ardhura nga babai me pagesa utilitare, mujore, periudha kohore 2010 - maj 2018. Më pas këtë shumë parash e transferova tek ABI Bank, me përqindje me të lartë interesi, në llogari ruajtëse po ashtu.
- Llogari bankare në ABI Bank, me vlerë 1.113.470 lekë, periudha 20.08.2020 deri në 07.03.2023. Burimi, transferimi nga llogaria Kid, i të ardhurave nga babai në Raiffeisen Bank 800.000 lekë dhe 300.000 marrënga llogaria rrjedhëse Union Bank.
- Viti shkollor 2018 - 2019, përfituar bursë prej 45.000 lekë, te SH.T.E.T. Të ardhura nga bursat e ekselencës.
- Viti shkollor 2019 - 2020, përfituar bursë prej 90.000 lekë te FEUT. Të ardhura nga bursat e ekselencës.

- Viti 2019 - 2021, kam luajtur si futbollist profesionist me klubin KF Laçi, ku kam përfituar të ardhura nga pagat, me vlerë 1.048.000 lekë per dy sezonet futbollistike, me llogari rrjedhëse te Union Bank.
 - Viti 2022, marr me qira nje plazh në Lllaman, Himarë, me NIPT M26517202Q, i cili përfundon me bilanc pozitiv, ku te ardhurat janë me vlerë 12.665.021 lekë dhe shpenzimet janë me vlerë 9.239.936 lekë, Subjekti Aldo Elmazi, person fizik me NIPT M26517202Q ka fituar shumën 3.425.082 lekë, me llogari në Alpha Bank.
 - Viti 2023 bëj mbylljen e biznesit me NIPT M26517202Q, ku të gjitha fitimet e tij i kaloj në Raiffeisen Bank dhe hap biznes të ri si person fizik në Tiranë, me NIPT M31324012I me llogari biznesi në Raiffeisen Bank, ku vazhdoj aktivitetin dhe sot. Vlera 1.232.755 lekë dhe 10.718 euro.
- Bashkëlidhur deklaratës:
- Certifikatë regjistrimi në QKB, datë 24.01.2023, për personin e tatueshëm Aldo Elmazi, me NIPT M31324012I, me adresë kryesore zk. 8370, nr. pasurie **, Tiranë.
 - Certifikatë regjistrimi në QKB, datë 17.03.2022, për personin e tatueshëm Aldo Elmazi, me NIPT M26517202QI, me adresë kryesore zk. 1952, nr. pasurie **, Lllaman.
 - Nxjerrje llogarie nga Union Bank, në emër të Aldo Elmazi, për periudhën 01.09.2019 - 28.01.2021, ku evidentohen kreditimet e bëra nga FF Laçi.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

1. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot, datë 12.09.2023, konfirmon llogari të çelur në vitin 2010, në emër të Aldo Elmazi, në të cilën janë kredituar periodikisht, nga Ardit Elmazi, shumat 5.000 lekë/muaj - 10.000 lekë/muaj. Në datë 20.08.2020, nga llogaria "Kid", Aldo Elmazi ka tërhequr një shumë prej 814.500 lekë. Gjithashtu konfirmon se për periudhën 2019 - 2020, Aldo Elmazi ka përfituar të ardhura nga bursa, në shumën 90.000 lekë. Gjendja në llogarinë "Kid", në datë 10.03.2023 është në vlerën 0 (zero) lekë.
2. ABI Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 19.09.2023, konfirmon se Aldo Elmazi, në datë 20.08.2020, ka derdhur në llogari një shumë prej 800.000 lekë dhe në datë 23.10.2023 edhe një shumë tjetër prej 300.000 lekë. Nga kjo llogari, në datë 08.03.2022, ka transferuar në llogarinë e shtetasit A. M., një shumë prej 1.100.000 lekë, me përshkrimin "sipas kontratës së qirasë nr. ** rep., nr. ** kol., datë 07.03.2022". Gjendja në këtë llogari në datë 10.03.2023 është në vlerën 0 (zero) lekë.
3. Credins Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 09.10.2023, konfirmon se Aldo Elmazi, për periudhën 30.11.2016 - 28.12.2018, ka përfituar të ardhura nga bursat, në shumën 135.000 lekë.
4. Union Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 04.10.2023, konfirmon se Aldo Elmazi, për periudhën 20.02.2020 - 31.12.2020, ka përfituar të ardhura nga KF Laçi, në shumën 978.000 lekë dhe ndihmë nga FSHF, në shumën 117.000 lekë. Nga kjo llogari në datë 09.03.2022, ka transferuar në llogarinë e shtetasit A. M., një shumë prej 400.000 lekë, me përshkrimin "kalim sipas kontratë qiraje ".

5. QKB, me shkresën nr. ** prot., datë 13.09.2023, konfirmon se Aldo Elmazi, figuron të jetë regjistruar në datë 24.01.2023, si PF, me NIPT M31324012I. Sipas ekstraktit, fusha e veprimtarisë është: Tregtim materiale ndërtimi, vegla pune, etj; Punime ndërtimi, etj; Import-Eksport; qiradhënie automjetesh; Turizëm, etj. Adresa e ushtrimit të aktivitetit: Pasuria nr. **, Zona Kadastrale nr. 8370, Tiranë. Statusi: Aktiv.
6. QKB online, konfirmon të regjistruar PF Aldo Elmazi, me datë 17.03.2022, me NIPT M26517202Q, me fushë veprimtarie "Bar-Restorant, shërbim katering". Adresa e ushtrimit të aktivitetit: Pasuria nr. **, zk, 1952, Llaman, Himarë. Statusi: Pezulluar me datë 31.08.2022 dhe regjistruar më datë 14.12.2022.
7. DRT Tiranë, me shkresën nr. ** prot., datë 25.09.2023 dhe nr. ** prot., datë 21.09.2023, konfirmon se Aldo Elmazi, rezulton i regjistruar si PF, me NIPT M31324012I, regjistruar më datë 24.01.2023 (me aktivitetet: tregti materiale ndërtimi dhe vegla pune). Nga ana e subjektit nuk janë dorëzuar deklarata të ardhurash, pasi nuk është përmbushur afati ligjor për dorëzimin e tyre.
8. DRT Tiranë, me shkresën nr. **, datë 21.09.2023, konfirmon se rezulton i regjistruar PF Aldo Elmazi, me NIPT M31324012I, më datë 24.01.2023, aktiviteti: Tregti materiale ndërtimi dhe vegla pune. Nuk ka të dhëna për xhiron e deklaruar dhe fitimin e realizuar nga ky subjekt, për periudhën 24.01.2023 - 10.03.2023, pasi ky subjekt ka detyrimin ligjor, për të dorëzuar deklaratën e të ardhurave për vitin 2023, brenda datës 10.02.2024.
9. DRT Vlorë, me shkresën nr. ** prot., datë 20.09.2023, konfirmon se Aldo Elmazi, i regjistruar në datë 17.03.2022, me NIPT M26517202O, për vitin 2022, ka pasur të ardhura në shumën 12.665.021 lekë, shpenzime 9.239.936 lekë dhe fitim në shumën 3.425.085 lekë.
10. ISSH, me shkresën nr. ** prot., datë 15.09.2023, konfirmon se Aldo Elmazi, për periudhën nëntor 2019 - mars 2023, rezulton i punësuar/ka përfituar të ardhura pranë: Klubi i Futbollit Laçi; Cullhaj Konstruksion; dhe PF Aldo Elmazi.
11. Me proces-verbalin e datës 04.03.2024, subjektit i'u kërkuan shpjegime dhe dokumente justifikuese, për deklaratimet e gjendjeve të llogarive nga djali në Raiffeisen Bank, e ABI Bank, për veprimtaritë private të djalit, pagesat e qirasë, si dhe punësimin e tij.
12. Me inventarët e datave: 11.03.2024 dhe 18.03.2024, subjekti paraqiti shpjegimet me shkrim, ku, në mënyrë të përmbledhur, sqaroi se, për sa i përket faktit se në llogari gjendja rezulton të ketë qenë 0 lekë (ndërkohë që ishin deklaruar me gjendje nga djali, kjo ka ndodhur për një keqkuptim, pasi në kolonën e deklaratimit shënohet "Shuma e të ardhurave neto të krijuara", dhe djali ka menduar se duhej të vendoseshin të ardhurat që kanë qenë akumuluar në këtë llogari. Lidhur me pagesën e qirave të kryera nga djali, shpjegoi se pagesa prej 1.500.000 lekë, për shtetasin A. M. ka qenë një pagese qiraje

për biznesin që kishte marrë djali prej A. M., ku sipas deklaratës nga ky i fundit, pagesa do i bëhej nipit të tij, A. M. Shuma 1.100.000 lekë për qiranë është paguar nëpërmjet ABI Bank, më datë 08.03.2022 dhe 400.000 lekë janë paguar nëpërmjet Union Bank, më datë 09.03.2022. Referuar kontratës së qirasë, ku shuma totale e qirasë ka qenë 2.000.000 lekë, diferenca e mbetur prej 500.000 lekë, është paguar nga djali pas përfundimit të sezonit turistik në formë cash.

13. Lidhur me aktivitetin privat të djalit në Himarë, shpjegoi se me anë të kontratës së qirasë, nr. ** rep., nr. ** kol., datë 07.03.2022, është marrë me qira aktiviteti "plazh privat sezonal", që përfshinte edhe sendet e luajtshme në shërbim të aktivitetit. Lidhur me investimin në këtë aktivitet, subjekti shpjegoi se nuk është investuar asnjë shumë nga djali, pasi objekti ku është ushtruar aktiviteti ka qenë ekzistues. Investimi është kryer i gjithi nga pala qiradhënëse përpara se të merrej me qira nga djali. Objekti i ndodhur në truallin për të cilin ka paraqitur certifikatën e pronësisë, është një objekt i ndërtuar me materiale të çmontueshme, për këtë arsye ai nuk është i evidentuar në certifikatën e pronësisë.
14. Marrëdhënia juridike me pronën në fjalë ka qenë vetëm qiramarrja. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga aktiviteti i djalit, sqaroi se në vitin 2023 është mbyllur aktiviteti (bar restorant plazh) me nipt M26517202Q, dhe një pjesë të fitimeve të tij djali i ka kaluar në Raiffeisen Bank dhe më pas, ka hapur një biznes të ri si person fizik në Tiranë, me nipt M31324012I. Në këtë aktivitet djali nuk ka kryer investime. Burimi i të ardhurave për blerjen e këtyre mallrave janë nga biznesi i mëparshëm me NIPT M26517202Q.
15. Lidhur me punësimin e djalit, shpjegoi se pranë shoqërisë "Cullhaj Konstruksion", ai nuk ka përfituar të ardhura. Kjo periudhë pune është pjesë e praktikës së programit mësimor Bachelor të Fakultetit Ekonomik, në Universitetin e Tiranës.
16. Për punësimin pranë "PF Aldo Elmazi" shpjegoi se edhe këtu djali nuk përfiton të ardhura nga paga, pasi është person fizik, i cili merr fitimet e veprimtarisë.
Bashkëlidhur:
 - Kontratë qiraje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 07.03.2022, lidhur mes qiramarrësit, Aldo Elmazi dhe qiradhënësit, A. M., për dhënie me qira të një pasurie me nr. **, e llojit truall, me sip. 2.853m², në Lllaman, Himarë. Trualli që jepet me qira është funksional për t'u përdorur nga qiramarrësi për ushtrim aktiviteti "plazh privat sezonal", pasi mbi këtë truall janë vendosur sende të luajtshme, që ndihmojnë krijimin e ambienteve për plazh privat. Cmimi i qirasë është 2.000.000 lekë, si dhe 3% të fitimit që do të realizojë gjatë ushtrimit të aktivitetit për periudhën që e merr me qira. Likuidimi i shumës 1.500.000 lekë do të paguhet brenda datës 15.03.2022, në llogarinë bankare të qiradhënësit, ndërsa diferenca prej 500.000 lekë, së bashku me 3% të fitimit do të paguhet në llogarinë bankare brenda muajit tetor 2022.
 - Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 28.01.2019, për pasurinë e llojit truall me nr. pasurie **, Himarë, me sip. 2.853 m², regjistruar në pronësi të A. M.
 - Kartela e pasurise. Harta treguese e regjistrimit.

- Deklaratë noteriale (nr. Axxxxxxx), lëshuar nga A. M., i cili deklaroi se ishte dakord që shumën e qirasë, sipas kontratës nr. ** rep., nr. ** kol., datë 07.03.2022, të kalojë në llogarinë bankare të A. M.
 - Formular urdhër transfertë në ABI Bank, datë 08.03.2022, për transferimin e shumës 1.100.000 lekë, nga Aldo Elmazi, për shtetasin A. M., me përshkrimin "kalim sipas kontratës së qirasë nr. ** rep., nr. ** kol., datë 07.03.2022".
 - Formular urdhër transfertë në Union Bank, datë 09.03.2022, për transferimin e shumës 400.500 lekë nga Aldo Elmazi, për shtetasin A. M., me përshkrimin "kalim sipas kontratës së qirasë nr. ** rep., nr. ** kol., datë 07.03.2022" dhe dokumente të hapje/mbylljes së llogarisë.
 - Nxjerrje llogarie nga Alpha Bank, për personin fizik Aldo Elmazi, në monedhën Lek, për veprimet bankare të tij të kryera në periudhën 12.07.2022 - 31.08.2022.
 - Nxjerrje llogarie nga Alpha Bank për personin fizik Aldo Elmazi, në monedhën Euro, për veprimet bankare të tij, të kryera në periudhën 18.07.2022 - 31.08.2022.
 - Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, për personin fizik Aldo Elmazi, në llogarinë në Lek, për veprimet bankare të tij të kryera në periudhën 27.01.2023 - 06.03.2024.
 - Vërtetim datë 27.02.2023, lëshuar nga DRT Tiranë, për kontributet e përlllogaritura nga shoqëria "Cullhaj Konstruksion" për Aldo Elmazin dhe dy listëpagesa.
 - Deklaratë noteriale nr. ** rep., nr. ** kol., datë 12.03.2024, lëshuar nga shtetasi A. M., i cili deklaroi se është pronar i pasurisë me nr: **, e llojit tokë truall me sip. 2.853 m², në Lllaman, Himarë dhe përgjatë viteve, që nga momenti që është bërë pronar i kësaj pasurie, ka investuar vit pas viti deri në momentin që e ka dhënë me qira, e cila i është dhënë shtetasit Aldo Elmazi, me kontratën nr. ** rep., nr. ** kol., datë 07.03.2022. Kjo pasuri i është dhënë Aldo Elmazit tërësisht e investuar.
 - Faturë tatimore shitje nr. **, datë 11.06.2021, për blerje kioske nga A. M., në shumën 2.800 euro.
 - Faturë tatimore shitje nr. **, datë 18.05.2021, për blerje materiale nga A. M. në shumën 877.500 lekë.
 - Faturë tatimore shitje nr. **, datë 29.05.2021, për blerje materiale nga A. M. në shumën 213.300 lekë.
 - Faturë tatimore shitje nr. **, datë 04.06.2021, për blerje mobiljesh nga A. M. në shumën 1.470.000 lekë.
 - Faturë tatimore shitje nr. **, datë 11.05.2021, për blerje materiale nga A. M. në shumën 144.000 lekë.
 - Faturë tatimore shitje nr. **, datë 12.06.2021, për blerje materiale nga A. M. në shumën 6.840 euro.
 - Faturë tatimore shitje nr. **, datë 03.07.2023, për blerje pajisje nga A. M. në shumën 4.000 euro.
 - Faturë tatimore shitje nr. **, datë 30.07.2021, për blerje pajisje nga A. M. në shumën 4.481 euro.
 - Ortofoto satelitore të objektit, me pamje të vitit 2019, 2022 dhe korrik 2023.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e paraqitur, shpjegimet e dhëna dhe përgjigjen e DRT dhe OKB, lidhur me aktivitetet private të djalit.**

- ✓ Për periudhën kur ka ushtruar aktivitetin privat në Himarë, në vitin 2022, personi fizik "Aldo Elmazi", me NIPT M265172020, ka pasur fitim në shumën rreth 3.425.000 lekë.
- ✓ Për vitin 2023, kur personi fizik "Aldo Elmazi", me NIPT M313240121 ka ushtruar aktivitetin privat në Tiranë, referuar ligjit tatimor, deklarimi i fitimit do të kryhet në vitin 2024.
- ✓ Për periudhën 2016 - 2020, Aldo Emazi ka përfituar të ardhura nga bursa në shumën 225.000 lekë, si dhe të ardhura nga veprimtaria sportive si futbollist në shumën 1.108.000 lekë.

DEKLARIMI I VAJZËS - KLEA ELMAZI

DEKLARIMI I PASURIVE

1. Llogari Kid në Raiffeisen Bank, me shumën 1.184.495 lekë, Zotërimi 100%.
Burimi: Të ardhura nga babai, me pagesa utilitare, mujore, periudha kohore 2010 - maj 2021.

Bashkëlidhur deklaratës:

- Nxjerrje llogarie nga Raiffeisen Bank, për llogari në emër të Klea Elmazi, ku gjendja në datë 28.02.2023, është në vlerën 1.184.495 lekë.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

1.1.Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 12.09.2023, konfirmon se Klea Elmazi, në datë 10.03.2023, ka pasur llogari rrjedhëse me gjendje 1.169.495 lekë. Nga të dhënat bankare, evidentohet se kjo llogari ka si burim financiar pagesa (thuajse) periodike prej vitit 2010, nga llogaria e babait Ardit Elmazi, në shumën nga 5.000 lekë - 10.000 lekë, si dhe nga interesat e vetë llogarisë. Ndryshimi i gjendjes së llogarisë së deklaruar me atë të konfirmuar nga RFZ Bank, ka ndodhur si rezultat i paraqitjes së tyre në dy data të ndryshme dhe konkretisht: Gjendja e deklaruar nga vajza e subjektit, i përket datës 28.02.2023, ndërsa konfirmimi i bankës i përket datës 10.03.2023.

- ✓ Nga analiza financiare e kryer, konstatohet se subjekti ka pasur mundësi financiare të ligjshme për krijimin e pasurisë me kursime familjare.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Viti shkollor 2021 - 2022, përfituar bursë prej 90.000 lekë, tek Fakulteti i Drejtësisë.
Burimi: të ardhura nga bursat për nxënësit e ekselencës.
- Viti shkollor 2019 - 2020, përfituar bursë prej 45.000 lekë nga Bashkia Tiranë, si nxënëse ekselente pranë shkollës Teknike Ekonomike.

Faktet e rezultuara nga hetimi administrativ:

1. Credins Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 09.10.2023, konfirmon se Klea Elmazi, për periudhën 19.12.2019- 13.07.2022, ka përfiturar të ardhura nga bursat, në shumën 129.838 lekë.
- ✓ **Për periudhën 2019 - 2022, vajza Klea ka përfiturar të ardhura nga bursa në shumën rreth 130.000 lekë.**

Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti ka deklaruar adresën ku është regjistruar në Gjendjen Civile: Rruga "Dervish Hekali", pallati "Rinia 04", kati i **, ap. **, Njësia Administrative nr. 8. Adresa e banimit e deklaruar nga subjekti, i përket apartamentit të deklaruar në pronësi, trajtuar më sipër.

Gjetje të Tjera:

- a. Banka e Shqipërisë, BKT, ISP Bank, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Fibank, OTP Bank, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, LandLease, Credins Invest, AK Invest, EasyPay. Fondi Besa, NOA sha, IuteCredit, Kredo.al, konfirmojnë se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk janë klient të tyre, cka konfirmohet me deklarinimin.
- b. ASHK në zyrat/drejtoritë vendore; Kamëz-Vorë, Zonat e Stimulura, Shkodër, Mat, Has, Vlorë, Lushnjë, Sarandë, Korçë, Mallakastër, Përmet, Tropojë, Devoll, Krujë, Peqin, Pukë, Malësi e Madhe, Pogradec, Librazhd, Skrapar, Bulqizë, Berat, Kukës, Kavajë, Kurbin, Gjirokastrë, Lezhë, Durrës, Gramsh, Fier, Mirditë, Kolonjë, Kuçovë, Elbasan, Dibër, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme në emër të subjektit.
- c. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot, datë 12.09.2023, konfirmon se Ardit Elmazi, në datë 10.03.2023, ka pasur llogari rrjedhëse me gjendje 20 lekë. Gjithashtu konfirmon se:
 - Gjatë vitit 2010, V. E. ka kredituar në llogarinë e Ardit Elmazit një shumë 620.000 lekë (me tre kreditime).
 - Në datë 09.11.2016, në llogarinë e Ardit Elmazit është kredituar një shumë prej 50.120 lekë nga ALBSIG, me përshkrimin "likujdim sipas praktikës TPL...".
- d. Me inventarët e datave: 11.03.2024 dhe 18.03.2024, subjekti paraqiti dokumente justifikuese dhe shpjegimet me shkrim, ku, në mënyrë të përmbledhur, sqaroi se: Kreditimi i shumës 620.000 lekë nga V. E. (nusja e xhaxhait të tij), është kryer për procedurat e regjistrimit të saj si studente, pranë universitetit privat "Kristal" dega Mjekësi. Duke qenë se tarifa e regjistrimit ishte me kosto më të lartë, ajo hoq dorë nga regjistrimi dhe vlerën monetare që subjekti i kishte tërhequr për regjistrim, ja ka dërguar asaj në qytetin e Sarandës, dorazi.
Kreditimi i shumës 50.120 lekë, nga shoqëria "Albsig" është paguar për dëmshpërblim nga kompania, për një dëm të shkaktuar nga një aksident ndaj makinës që dispononte në atë kohë, me targë AA330NF, të deklaruar në deklaratën e interesave private "Para fillimit të detyrës 2016" në vlerën 4.000 euro. Këtë automjet e ka shitur në vitin 2017.

Subjekti sqaroi gjithashtu, se automjetin Mercedes Benz, me targa AA330NF, e ka blerë sipas faturës së blerjes së datës 19.12.2015, në shumën 700 euro, nga djali i tezes së tij, E. G. Në momentin e blerjes ky automjet ka qenë i dëmtuar nga breshëri dhe me motor të djegur. Pasi e ka blerë dhe i ka paguar doganën në shumën rreth 70.000 lekë, ka kryer dhe pagesat për taksa, targa dhe riparimet e nevojshme të mjetit, te cilat në total kane shkuar rreth 4.000 euro, prandaj edhe në deklaratën e pasurisë, kur ka deklaruar këtë automjet e ka deklaruar në vlerën 4.000 euro.

Bashkëlidhur paraqiti:

- Vërtetim nr. 262 prot., datë 04.03.2024, lëshuar nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë, që vërteton se V. E., ka qenë punonjëse pranë kësaj drejtorie prej datës 01.04.1997, deri me datë 01.03.2024 dhe është larguar, pasi ka plotësuar moshën për përfitimin e pensionit.
 - Vërtetim nr. extra prot, datë 07.03.2024, lëshuar nga ALBSIG, i cili vërteton se Ardit Elmazi është paguar për dëmshpërblim TPL, me nr. praktike 16/TPL/DR2/xxxxV-01, në Raiffeisen Bank, në datë 09.11.2016, për vlerën 50.120 lekë. Dëmshpërblimi është për mjetin me targa AA 330 NF dhe shkaktari i dëmit ka qenë automjeti me targa AA 783 OC.
 - Deklaratë shitje (në italisht), datë 19.12.2015, nënshkruar E. G., për shitjen e automjetit Daimler Chrysler, shtetasit Ardit Elmazi, në shumën 700 euro.
 - Deklaratë doganore, datë 31.12.2015, për zhdoganimin e mjetit Daimler Chrysler nga Ardit Elmazi, për shumën 69.954 lekë.
 - Kontrate shitblerje nr. 3093 rep., nr. 1290 kol., datë 21.08.2017, për automjet Daimler Chrysler (Mercedes Benz), me targa AA 330 NF. Shitës: Ardit Elmazi, Blerës: A. R. Cmimi: 6.000 euro.
- e. Unioni Financiar, me shkresën nr. ** prot., datë 14.09.2023, konfirmon se Ardit Elmazi, për periudhën 07.09.2018 - 10.03.2023, ka kryer një transaksion në dalje në shumën 250 euro, ndërsa Aldo Elmazi ka kryer një transaksion në hyrje, në shumën 100 euro dhe një tjetër në shumën 4.000 lekë.
- f. Me proces-verbalin e datës 04.03.2024, subjektit iu kërkuan shpjegime dhe dokumente justifikuese, lidhur me sa konfirmuar nga Unioni Financiar. Me inventarin e datës 11.03.2024, subjekti paraqiti shpjegimet me shkrim, ku, në mënyrë të përmbledhur, sqaroi se, shuma prej 250 euro i është dërguar dajos së tij, L. H., që ka qenë me pushime në Turqi, në adresën e shoqëruesit të grupit turistik, ku daja ka qenë pjesë. Për vlerën 100 euro dhe 4.000 lekë, djali i tij nuk e mban mend, por mendon se duhet të keët qenë ndonjë shok i tij. Faturat e transferimit deklaror se nuk i ka ruajtur. Subjekti dha shpjegime për sa konfirmuar në emër të tij dhe të djalit Aldo, nga Unioni Financiar.
- g. DPSHTRR, me shkresën nr. ** prot., datë 18.09.2023, konfirmon se Ardit Elmazi dhe personat e lidhur me të, aktualisht nuk kanë mjete të regjistruara. DPSHTRR, me postën elektronike të datës 31.10.2023, konfirmon se Shpresjona Elmazi ka pasur në pronësi automjetin me targa AA900ME (AA670EE). Bashkëlidhur:

- Kontratë shitje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 10.08.2015, për automjet Daimler Chrysler, me targa AA670 EE. Blerës: Shpresjona Elmazi. Shitës: Xh. B. Cmimi: 2.000 euro.
 - Kontratë shitje nr. ** rep., nr. ** kol., datë 09.07.2016, për automjet Daimler Chrysler, me targa AA 900 ME. Shitës: Shpresjona Elmazi. Blerës: S. T. Cmimi: 200.000 lekë.
- h. Ka në pronësi automjetin me targa AB 002 KE.
Bashkëlidhur: Faturë blerje automjeti datë 04.09.2023 (në italisht). Blerës: A. H. Cmimi: 6.500 euro. + Deklaratë doganore datë 07.09.2023, për automjet Jaguar, me importues PF A. H. Vlëra e mjetit e shënuar në faturë: 6,500 euro, Pagesa e zhdoganimit: 224.088 lekë, Faturë tatimore shitje nr. **/2023, datë 23.09.2023, për automjet tip Jaguar. Blerës: Shpresjona Elmazi. Shitës: A. H. Vlëra 10,000 euro. + Deklaratë shitje automjeti.
- i. Me proces-verbalin e datës 04.03.2024, subjektit iu kërkuan shpjegime dhe dokumente justifikuese lidhur me sa konfirmuar nga DPSHTRR, për automjetin me targa AA 900 ME, si dhe për një automjet tjetër të deklaruar prej tij në deklaratat e interesave private "Para fillimit të detyrës 2010" të blerë në vitin 2005, në vlerën 600.000 lekë.
- j. Me inventarët e datave: 11.03.2024 dhe 18.03.2024, subjekti paraqiti shpjegimet me shkrim, ku, në mënyrë të përmbledhur, sqaroi se, për blerjen e automjetit me targa AA 900 ME, si burim financiar janë përdorur kursimet, ndërsa lidhur me automjetin tjetër Mercedes Benz, të deklaruar prej tij në deklaratën e interesave private "Para fillimit të detyrës 2010" subjekti shpjegoi se automjeti ka qenë me letra të huaja dhe ka qenë në pritje të regjistrimit nga ana e shitësit, por duke qenë se kjo nuk ndodhi, pasi e ka përdorur automjetin për disa vite, në vitin 2015 e ka çuar për skrap për shumën 30.000 lekë, por nuk disponon dokumente, pasi magazina e skrapit nuk të pajiste me dokumente. Gjithashtu edhe kontratën e blerjes për këtë automjet nuk e disponon, pasi ka qenë në pritje të bëhej regjistrimi i automjetit. Si burim financiar për blerjen e tij ka shpjeguar se kanë shërbyer paga dhe kursimet.
- k. Subjekti dha shpjegime për burimin financiar të përdorur për blerjen e automjetit të b/shortes, me targa AA 900 ME, konfirmuar nga DPSHTRR, i bërë prej saj në vitin 2015 dhe shitur në vitin 2016.
- l. Subjekti dha shpjegime edhe për automjetin Mercedes Benz, të deklaruar prej tij në deklaratën e interesave private ndër vite, të blerë në vitin 2005 me cmimin 600.000 lekë, për të cilin deklaroi se nuk zotëron kontratë, pasi ka qenë pa dokumente çregjistrimi. Për mungesën e dokumentacionit justifikues, lidhur me blerjen e këtij mjeti, është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1. e ligjit nr. 12/2018 "Për Vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Cështjet e Brendshme dhe Ankesat", i ndryshuar. Automjetin në fjalë, subjekti deklaroi se në vitin 2015 e ka dorëzuar në një magazinë skrapit, për 30.000 lekë.

m. Automjeti tjetër, me targa AB 002 KE, të cilin DPSHTRR e konfirmon në pronësi të b/shortes, rezulton se është blerë nga b/shortja në datë 23.09.2023, datë kjo pas dorëzimit të Deklaratës së Pasurisë, Vetting.

n. Drejtoria e Përgjithshme Detare, me shkresën nr. ** prot., datë 20.09.2023, nuk konfirmon mjet lundrues në pronësi të subjektit dhe personave të lidhur me të.

✓ ***Në konkluzion për vlerësimin e pasurisë, në përputhje me pikën 6 të nenit 34 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:***

a) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe se punonjësi nuk gjendet në situatë konflikti interesi;

b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;

c) nuk është kryer fshehje e pasurisë;

ç) nuk është kryer deklarim i rremë;

d) punonjësi nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Analiza financiare e subjektit dhe personave të lidhur me të

Burimi/Viti	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2015	2015	2016	2017	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	TOTALI			
Te ardhura neto nga paga apo shperblime nga marrëdhëniet e punësimit	313,477	549,806	122,468		1,037,055	602,486	667,410	735,662		720,556	744,313	796,858	983,605	898,228	859,134	1,285,338			1,061,757	957,557		1,019,894	1,148,693	1,104,059	1,147,891	1,225,878	1,012,615	312,971	19,307,711			
Te ardhura neto nga paga apo shperblime per bashkeshorten					52,410	241,711	281,787	341,234		361,855	419,021	399,636	385,760	508,588	544,861	560,343			575,992	554,442		578,865	552,447	560,311	718,048	802,976	851,550	75,788	9,367,625			
Te ardhura nga aktiviteti si Arbitër Boks			144,000	144,000	144,000	144,000	144,000	144,000		144,000	144,000	144,000	144,000																1,440,000			
Te ardhura nga bursa dhe si futbolist-Aldo Elmazi																					45,000	20,000							1,463,000			
Te ardhura nga aktiviteti ekonomik -Aldo Elmazi																													3,425,085			
Te ardhura neto nga interesat bankare										9,076	27,230	27,230	27,230	27,230	9,076								70,668			130,741	124,353		452,835			
Te ardhura te krijuara nga shitje e pasurive te bashkes dhe te pajisjesh																													243,620			
Te ardhurat neto nga qeraje																								62,620	379,964	357,000	394,713	117,712	1,312,009			
Te ardhura te krijuara nga investimet ne títuj																142,079				19,046									161,125			
Te hyra nga dhurimet																													2,500,000			
Totali i E Ardhurave dhe te Hyrat	313,477	549,806	266,468	144,000	1,233,465	988,197	1,093,197	1,220,896	-	1,235,487	1,334,564	1,367,724	1,540,595	1,434,046	1,413,071	1,987,760	-	-	4,156,795	1,556,999	263,620	1,598,759	1,841,808	1,861,990	3,353,903	2,601,595	5,683,963	630,824	39,673,010			
Detyrime: Te hyra nga huatë/kredit								2,200,000											2,500,000				1,000,000						5,700,000			
Shpenzime jetike sipas INSTAT	324,000	280,836	280,836	319,841	374,448	442,848	442,848	942,912		546,480	853,008	941,863	1,066,260	697,740	697,740	959,065			985,919	1,036,255		992,933	1,060,332	1,140,672	1,195,908	1,214,676	1,289,268	214,878	18,301,566			
Shpenzime-qera	87,143	87,143	87,143	87,143	87,143	87,143	87,143	87,142																						610,000		
Shpenzime-humbje nga shitja e pasurive/bsh.																														-		
Shpenzime për Arsimimin																														81,900		
Shpenzime Udhëtimi jashte vendit																														81,900		
Dhënie Huaz pa interes					400,000		800,000																								35,000	
Shpenzime Kredite Bankare, Hua,Leasing										300,000				700,000									18,398	171,835	345,015	345,347	207,952			20,000	218,800	
Shpenzime dhe te dala te tjera-mobilimi																							1,000,000								24,420	
Totali i shpenzimeve dhe te dalave	411,143	367,979	367,979	406,984	861,591	529,991	1,329,990	942,912	-	846,480	853,008	941,863	1,766,260	697,740	697,740	1,040,965	-	-	1,067,819	1,036,255	-	992,933	2,078,730	1,312,507	1,600,343	1,646,165	1,915,551	252,043	23,964,971			
Investime pasuri-apartament								1,900,000																							7,000,000	
Investime pasuri-autoveture						600,000													279,040	600,000	550,600	279,040	550,600	865,280							865,280	
Lk. ALL. A.S.Elmasi-Tirana Bank-llq.paga													134,446	134,549	2	105					106											
Lk. ALL. Ardit Elmasi ProCredit Bank								1,000,000	1,000,000																							
Lk. ALL. Aldo Elmazi-ABI Bank																															1,100,000	
Lk. ALL. Sh.Elmasi Credins Bank-llq.paga																44,007						120,102	4,848	(155,025)	171,091	144,646	140,280	225,712	239,141	91,066	726,880	
Lk. ALL. Aldo Elmazi-Credins Bank																						45,000		45,000	45,000							
Lk. ALL. Aldo Elmazi-Union Bank																									762,072	(52,788)	(560,473)	(79,997)				
Lk. ALL. Ardit Elmasi Raiffeisen Bank					20,373	998	500,000		557,483	34,036	31,571	20,737	13,264	6,331	188,082							187,704	74,706	50,127	76,221	53,986	478,927	1,010,540	707,043	199,568	2,553,067	
Lk. EURO Ardit Elmasi Raiffeisen Bank								30,302	28,656													1,371			74,248	259,556	(120,487)	167,400	134,033		515,025	
Lk. Deposite- ALL. Ardit Elmasi Raiff. Bank								1,000,000																								
Lk. ALL. Sh.Elmasi Raiffeisen Bank					91,630	62,209	21,232		32,946	1,660	19,837	28,740	77,570	216,359	301,060											13						
Lk. ALL. Aldo Elmazi Raiffeisen Bank												20,000	60,215	68,806	131,225	148,823					119,496	107,596		68,933	8,900	81,900		31,560	500,000	630,650		
Lk. EURO Aldo Elmazi Raiffeisen Bank																																
Lk. ALL. Klea Elmasi Raiffeisen Bank												20,115	62,840		197,292	251,708						121,606	108,938		70,289	232,021	134,368		25,456	9,212	64,330	1,169,495
Lk. ALL. Dion Elmasi Raiffeisen Bank												20,114	62,840	66,067	131,225	148,823					119,496	107,596		68,933	130,037	131,695	22,741	42,930	134,229	30,000	1,216,726	
Investim Raiffeisen Invest																1,704,700	295,300															
Gjendje Cash (ndryshimi: shtim /pakesim)																															1,704,700	
Totali Pasuri	-	-	-	-	-	712,003	61,211	3,421,232	1,000,000	439,873	3,720	61,637	1,972	333,728	887,134	775,578	279,040	600,000	5,842,331	159,948	550,600	823,270	654,370	215,151	2,844,970	1,131,363	323,393	9,111	17,237,791			
Mundësia per Kurrime :																																
Te Ardhura-Detyrime-Shpenzime-Pasuri.	97,666	84,161	17,350	280,334	91,540	162,257	337,839	281,087	1,000,000	50,866	426,970	241,194	13,557	416,135	244,332	415,549	279,040	600,000	483,154	843,950	814,220	1,440,726	1,549,434	1,885,766	794,356	618,423	4,063,442	4,451,334				

B. KONTROLLI I FIGURËS:

1. Objekti i kontrollit të figurës, sipas nenit 35 të Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar është verifikimi i deklaramëve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklaramëve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.
2. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, e kryer nga Trupa Vlerësuese është mbështetur në katër elementë:
 - (i) të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e kontrollit të figurës, sipas përcaktimeve të Nenit 36, pika 1, Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - (ii) raporti i hollësishëm dhe i arsyetuar i strukturës përgjegjëse pranë AMP-së sipas përcaktimeve të Nenit 42, pika 1 e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - (iii) të dhënat e mbledhura nga Trupa e Vlerësimit, në institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të Nenit 36, pika 3, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
 - (iv) verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të Nenit 36, pika 3, gërma (ë), e Ligjit 12/2018, i ndryshuar.
3. Subjekti Ardit Elmazi ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në zbatim të Nenit 36, pika 1 e Ligjit nr.12/2018, të ndryshuar.
4. Në Raportin mbi Kontrollin e Figurës për subjektin e vlerësimit nr. ** prot., datë 19.12.2023, përgatitur nga AMP, trupa është informuar se subjekti i vlerësimit Ardit Elmazi është i përshatshëm për vazhdimin e detyrës.
5. Në *Deklaratën për Kontrollin e Figurës¹, Subjekti i vlerësimit, Ardit Elmazi, nuk ka raportuar ndonjë të dhënë për të cilën duhej të fillonte verifikimi i thelluar sipas kritereve dhe kushteve të ligjit nr.138/2015 dhe në zbatim të detyrimit të ligjit të posaçëm nr. 12/2018, i ndryshuar.*

1

- Nuk ka pasur emër apo mbiemër tjetër më parë.
- Nuk është njohur nga të tjerët me ndonjë nofkë, emër apo mbiemër tjetër nga ai që ka të regjistruar në gjendjen civile.
- Nuk ka patur shtetësi tjetër.
- Nuk është dënuar ndonjëherë më vendim gjyqësor të formës të prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- Nuk ka qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një veprë penale.
- Nuk është ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një veprë penale.
- Nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë penale.
- Nuk ka patur urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- Nuk është marrë ndonjëherë masa e dëbimit nga një shtet i huaj.
- Nuk është në dënim të përfshirjes së ndonjë nga anëtarët e familjes në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- Nuk ka patur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi të qëllimshëm, me një ose shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës.
- Nuk ka patur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar gjatë ushtrimit të detyrës.
- Nuk është në dënim të anëtarët e familjes kanë patur kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Nuk është në dënim të ndonjë nga anëtarët e familjes të ketë pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- Gjatë 10 viteve të fundit, nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s.
- Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- Nuk ka fshehur apo keqprezantuar, falsifikuar, një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të vecantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të pa autorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- Nuk ka kërkuar ndonjëherë azil politik.
- Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- Nuk ka varësi nga alkoli dhe lojrat e fatit.
- Nuk ka vuajtur nga crregullime mendore kronike.
- Nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1991 sipas ligjit "Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

6. Për të kontrolluar figurën dhe saktësinë e deklaramit për subjektin e vlerësimit, janë kryer veprimet duke kërkuar të dhëna me anë të korrespondencës pranë këtyre institucioneve:

✚ **AKSIK**

✚ **SHISH**

✚ **AMP**

✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve**

✚ **Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria Gjyqësore**

✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile**

✚ **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**

✚ **Avokati i Popullit**

✚ **AISM**

✚ **Prokuroria e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK)**

✚ **Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit**

✚ **AIF**

7. Procedura për kontrollin e figurës është kryer sipas përcaktimeve të Nenit 36-37 të ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” të ndryshuar, bazuar në kontrollin e deklaramive dhe marrjes së informacionit apo materialeve të tjera nga institucionet publike dhe ato ligjzbatuese, duke i vlerësuar ato bazuar në dispozitat e neneve 38 - 41 të Ligjit nr.12/2018 të ndryshuar.

8. Në bazë të informacionit të dërguar nga institucionet përgjegjëse, ka rezultuar se:

✓ Subjekti i vlerësimit është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), nivelin e klasifikimit “Tepër Sekret”, me datë lëshimi 13.12.2021, të vlefshme deri në datë 12.12.2026.

Nga AKSIK nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm CSP. AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

✓ Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën e saj bën me dije se për subjektin e vlerësimit Ardit Selman Elmazi, nuk ka ndryshuar apo marrë shtetësi tjetër, nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit.

✓ Nuk ka patur ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht nga Avokati i Popullit, konfirmuar me shkresë.

✓ Nuk ka denoncime nga publiku në faqen zyrtare të AMP dhe nuk disponohen ankesa për subjektin e vlerësimit.

✓ Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, konfirmon se shtetasit Ardit Selman Elmazi, Shpresjona Faik Elmazi, Aldo Ardit Elmazi dhe Klea Elmazi nuk rezultojnë të dënuar.

✓ Institucioni ligjzbatues dërgon informacion se për subjektin e vlerësimit rezultojnë të dhëna të pavërtetuara, si dhe Institucioni nuk ka ndarë informacion me institucionet shtetërore për

subjektin. Gjithashtu, institucioni verifikues, AMP, ka kryer verifikimet përkatëse në terren dhe në përfundim nuk kanë konfirmuar vërtetësinë e tyre.

- ✓ Institucioni ligjzbatues dërgon informacion se për subjektin e vlerësimit dhe personat e tij të lidhur nuk administrohen informacione ose materiale mbi përfshirjen në aktivitete të kundërligjshme, nuk ka të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga ndonjë shtet i huaj, nuk ka të dhëna nëse gjatë 10 viteve të fundit i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s apo nëse është kërkuar azil politik në ndonjë shtet të huaj.
- ✓ Institucioni ligjzbatues dërgon informacion se për subjektin e vlerësimit nuk disponon të dhëna.
- ✓ Prokuroria e Përgjithshme dhe Prokuroria e Posacme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), informon se për subjektin e vlerësimit nuk ka nxjerrë urdhër ndalimi, nuk ka kërkuar masa të sigurimit personal (masa shtrënguese/ masa ndaluese, sipas përcaktimeve të nenit 227 të Kodit të Procedurës Penale) dhe vlerësimi i tyre nga Gjykata, nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo person nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale, nuk ka pasur regjistrim të njoftimit të veprave penale sipas përcaktimit të nenit 278 të Kodit të Procedurës Penale dhe nuk ka pasur raste të urdhërave ndërkombëtarë të ndalimit.
- ✓ Institucioni ligjzbatues për subjektin e vlerësimit informon se nuk ka të dhëna për përfshirje në aktivitete të kundërligjshëm, nuk ka procedime penale të referuara dhe nuk administrohen të dhëna ose informacione.
- ✓ AIDSSH-ja për subjektin e vlerësimit bën me dije se nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri në 2 korrik 1991.

9. Testimi për përdorim lëndësh narkotike

9.1 Në zbatim të Nenit 38, pika 2 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, me qëllim vlerësimin e besueshmërisë së punonjësit dhe deklarimeve personale, subjekti i vlerësimit ka kryer testin për përdorim lëndësh narkotike.

9.2 Në përfundim të testit, sipas ekzaminimit toksikologjiko-ligjor nr. **, datë 27.05.2024 të ardhur nga Instituti i Mjekësisë Ligjore, me shkresë nr. ** prot., datë 29.05.2024, jemi bërë me dije se:

“Në mostrën e marrë subjektit nuk u zbulua prania e produkteve të lëndëve narkotike të grupit të MOP(opiate/heroinë), COC (cocaine), MTD (metadon), THC (canabinoide/cannabis sativa), BARB (barbiturate), TCA (triciklike antidepressante), AMP (amphetamine), MDMA (ekstazi), MET (metamfetamina), u zbuluan produktet e metabolizmit të benzodiazepinave (BZO). Me shkresën nga IML, nr. ** prot., datë 28.06.2024, në përgjigje tonës, jemi bërë me dije se: “Subjekti në momentin e dorëzimit të mostrës së urinës në Laboratorin Toksikologjisë, më datë 23.05.2024, ka deklaruar se për arsye shëndetsore trajtohet me barna si: Flecainide dhe Kinox. Benzodiazepinat veprojnë në sistemin nervor qendror dhe përdoren

në doza terapeutike për veprimin e tyre si anksiolitikë, anticonvulsant dhe relaksues të muskulaturës.”

Në kthim përgjigjet nr. ** prot., subjekti ka sqaruar se: “Në lidhje për sa më sipër, ju bëj me dije se në momentin e marrjes së mostrës së urinës kam qenë nën efektin e disa medikamenteve farmaceutike, si pentakoli 500 mg, qetësues dhimbjesh benketoli, valium etj. Këto medikamente merreshin nga ana ime me rekomandim të mjekut Dr. E.B., pasi unë në datë 13.05.2024 i jam nënshtruar një ndërhyrje kirurgjikale. Bashkëlidhur recetat e ilaceve si dhe fletë dalja nga Spitali “Nënë Tereza”, Tiranë, datë 14.05.2024.”

✓ **Nga administrimi i provave, Trupa Vlerësuese, konstatoi se deklaratimet e subjektit përputhen me dokumentacionin e dorëzuar.**

✓ *Në konkluzion për vlerësimin e figurës, në përputhje me pikën 3 të nenit 42 të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:*

- a) *punonjësi nuk ka kryer deklaratim të rremë;*
- b) *nuk ka informacione, të dhëna të vërtetuara nga agjencitë ligjzbatuese që punonjësi është i përfshirë ose i dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar;*
- c) *nuk ka informacion në deklaratimin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj, që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*

C- VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit; respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në zbatim të ligjit të vlerësimit nr.12/2018, i ndryshuar si dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit, sipas përcaktimit në nenin 43 të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

2. Analiza ligjore e vlerësimit të aftësive profesionale e kryer nga Trupa Vlerësuese është mbështetur në:

- a) të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;
- b) të dhënat e mbledhura në institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 6, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;

c) raporti i hollësishëm dhe i arsyetuar i strukturës përgjegjëse pranë DPPSH-së sipas përcaktimeve të Nenit 46, pika 2 e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar;

3. Trupa përdor si burime për vlerësimin e aftësive profesionale, elementet vlerësuese të përcaktuara në nenin 45, pika 2 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.
4. Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit mban në konsideratë dhe merr në shqyrtim edhe nëse ka denoncime nga publiku për sjellje jo profesionale të punonjësit, apo informacione të tjera të lidhura me ushtrimin e detyrës së tij në mënyrë joetike.
5. Në Raportin mbi Vlerësimin e Aftësive Profesionale për subjektin e vlerësimit nr. ** prot., datë 01.09.2023, përgatitur nga AMP, trupa është informuar se subjekti i vlerësimit Ardit Elmazi është i përshatshëm për vazhdimin e detyrës.

6. Afati kohor brenda të cilit shtrihet procesi i vlerësimit të aftësive profesionale:

- 6.1 Subjekti i vlerësimit, ka dorëzuar në njësinë e burimeve njerëzore të institucionit ku punon formularin e vlerësimit të aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit nr.12/2018 i ndryshuar.
- 6.2 Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën bazuar në përcaktimet e Nenit 44 pika 2 dhe 3 e tij ².
- 6.3 Subjekti i vlerësimit kalimtar në momentin e dorëzimit të dokumentacionit ka ushtruar detyrën e Zëvendësdrejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë.

7. Niveli i arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin, të subjektit të vlerësimit:

- 7.1 Subjekti i vlerësimit sipas të dhënave të administruara ka përfunduar arsimin e lartë dhe është diplomuar:
 - **Akademia e Policisë, Tiranë, Diploma nr. 323- A, datë 01.08.1999.**
 - **Universiteti “Kristal”, Tiranë, DNP(Drejtësi) nr.1520, datë 08.10.2009.**
 - **Universiteti “Albanian University”, Tiranë, Diplomë Post Master, (Studime mbi Sigurinë), nr. 438, datë 21.07.2011.**
- 7.2 Në kuptim të legjislacionit për Policinë e Shtetit në vite, bazuar dhe në kriteret dhe kërkesat e vecanta të pozicioneve të punës për funksionet përkatëse që ka mbajtur subjekti për

².Periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën dhe/ose pozicionin që mban, por jo më shumë se 5 vjet. 3. Në rast se punonjësi, në momentin e plotësimit të formularit të vetëvlerësimit profesional, ka më pak se 5 vjet në gradën dhe/ose pozicionin që mban, periudhë vlerësimi konsiderohet e gjithë koha e ushtrimit të detyrës në institucionin përkatës.

periudhën e përcaktuar në pikat 2 e 3 të nenit 44, të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, rezulton se: Subjekti i vlerësimit ka qenë në përmbushje dhe përputhje të kriterit të nivelit arsimor për funksionet që ka ushtruar, si dhe me gradat policore që ka mbajtur si punonjës i Policisë së Shtetit.

8. Të dhënat për punësimin dhe ecuria në karrierë:

8.1 Neni 45, pika 2, shkronja dh, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar përcakton se: në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë edhe ecuria në karrierë dhe procesi i fitimit të gradës, sipas legjislacionit në fuqi.

8.2 Struktura përgjegjëse e burimeve njerëzore e Policisë së Shtetit na ka vënë në dispozicion dosjen e personelit të subjektit të vlerësimit në të cilën përfshihen akte të ndryshme që i përkasin arsimimit, punësimit, ngritjes në detyrë, gradimeve, kualifikimeve, vlerësimeve, etj... të cilat janë marrë në analizë për vlerësimin profesional të subjektit.

8.3 Në formularin e aftësive profesionale plotësuar nga subjekti i vlerësimit si dhe nga dosja personale e subjektit rezulton se 5 (pesë) vitet e fundit subjekti i vlerësimit ka punuar në funksionet si më poshtë:

- **Shef Komisariati i Policisë nr.3 Tiranë, për periudhën 01.11.2016 deri në 24.03.2019 - sipas Urdhërit nr. 67/3, datë 26.10.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.**
- **Shef Komisariati i Policisë nr.6 Tiranë, për periudhën 25.03.2019 deri në 11.05.2021 - sipas Urdhërit nr. 333, datë 25.03.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.**
- **Shef Komisariati i Policisë Kolonjë, për periudhën 12.05.2021 deri në 04.11.2021 - sipas Urdhërit nr. 714, datë 10.05.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.**
- **Specialist në Drejtorinë kundër kundër Krimeve ndaj Personit dhe Pasurisë, pranë DPPSH, për periudhën 05.11.2021 deri në 30.12.2022 - sipas Urdhërit nr. 714/1, datë 04.11.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.**
- **Zëvendës drejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Korçë, për periudhën 31.12.2022 deri në momentin e dorëzimit të Formularit të Vlerësimit të Aftësive Profesionale - sipas Urdhërit nr. 2853, datë 31.12.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.**

8.4 Sipas Vendimit nr.892, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për Gradat në Policinë e Shtetit”, sipas Tabelës së Funksioneve Korresponduese dhe Kategorizimit për cdo Gradë”, dhe Vendimit nr.531, datë 29.07.2022 të Këshillit të Ministrave, “Për Miratimin e Numrit të Përgjithshëm të Personelit të Policisë së Shtetit dhe Përcaktimin e Funksioneve Korresponduese dhe Kategorizimin për Gradat në Policinë e Shtetit”, për funksionet Shef Komisariati i Policisë dhe Specialist në DPPSH, subjekti duhet të mbajë gradën Kryekomisar, ndërsa për funksionin Zëvendës drejtor në DVP, duhet të mbajë gradën Drejtues.

8.5 Rezulton se subjekti ka qenë në përputhje të funksionit me gradën sipas legjislacionit në fuqi të sipërcituar, për të gjitha emërimet dhe detyrat e ushtruara prej tij.

8.6 Nga aktet e dosjes së personelit, rezulton se subjekti i vlerësimit deri në momentin e deklarimit (5 vitet e fundit) ka përfituar gradat policore si më poshtë:

➤ **Drejtues:** **Urdhër nr.2853, datë 30.12.2022**

8.7 Trupa Vlerësuese konstatoi se përfitimi i gradës Drejtues është kryer sipas dokumentacionit si më poshtë:

- Urdhëri nr.1026, datë 10.11.2021, “Për hapjen e fazës së aplikimeve për konkurim për fitimin e gradës “Drejtues i Parë” dhe “Drejtues”.
- Vendimi nr.2814/14 datë 22.04.2022 të Komisionit të Gradimit për vlerësimet e aplikantëve që konkurojnë për fitimin e gradës “Drejtues”.
- Urdhëri nr.408/1, datë 05.05.2022 të Drejtorit të Policisë së Shtetit “Për miratimin e listës emërore të së drejtës për gradë të aplikantëve fitues”.
- Vendimi nr.1/1, datë 19.05.2022, të Komisionit për Vlerësimin e Programeve të Shkollimit/Trajnimit të Aplikantëve për marrjen e gradës “Drejtues”, në Akademinë e Sigurisë.
- Shkresa nr.1558 prot., datë 22.07.2022 e Akademisë së Sigurisë.
- Urdhëri nr.2853, datë 30.12.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për dhënien e gradës policore, transferimin dhe emërimin e një punonjësi policie”, ku subjekti ka marrë gradën “Drejtues”.

8.8 Në përfundim të verifikimit, rezulton se grada është përfituar në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

9. Vlerësimet e punës:

9.1 Neni 45, pika 2, shkronja ç, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar përcakton se: në lidhje me objektin e vlerësimit të aftësive profesionale shërbejnë edhe vlerësimet e punës.

9.2 Nga aktet e depozituara pranë Trupës Vlerësuese si dhe administrimi i dosjes së personelit, rezulton se: për vitet 2018, 2019, 2020 subjekti është vlerësuar me 26 pikë nga 28 pikë

maksimalja dhe për vitin 2021, subjekti ka vlerësim pune “I vecantë” (jo vjetor), për periudhën 13.05.2021 deri 28.09.2021, vlerësuar “shumë mirë”, me pikët maksimale 28 pikë për të gjithë treguesit si: integriteti, profesionalizmi, komunikimi efektiv, qëndrimi konstruktiv, paanshmëria, puna në grup dhe organizimi i punës.

- 9.3 Për vitin 2022 subjekti është vlerësuar “shumë mirë” (98 pikë në total), duke arritur për komponentin e “realizimit të objektivave të punës” të vlerësohet me 60 pikë nga 60 pikë në total dhe për komponentin e “sjelljes profesionale” është vlerësuar me 38 pikë nga 40 pikë në total.
- 9.4 Institucioni i Avokatit të Popullit, me shkresë ka konfirmuar se nuk ka pasur ankesa të trajtuara apo hetime administrative të nisura kryesisht për subjektin.
- 9.5 Pranë AMP-së, nuk kanë ardhur denoncime/ankesa nga publiku për subjektin për sjellje joprofesionale dhe joetike, gjatë ushtrimit të detyrës të tij sipas parashikimit ligjor të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar.

10. Përmbushja e detyrave të kryera

- 10.1 Neni 43, i Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, përcakton se objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është dhe përmbushja e detyrave nga punonjësi, në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin përkatës që rregullon veprimtarinë e punonjësit.
- 10.2 Neni 45, pika 1, e Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar përcakton se: aftësitë profesionale të punonjësit vlerësohen duke u bazuar dhe në përshkrimet e punës për cdo funksion.
- 10.3 Nga verifikimi rezulton se subjekti ka kryer dhe ka përmbushur detyrat në përputhje me përshkrimet e punës për cdo funksion.

11. Respektimi i rregullave të etikës/masat disiplinore:

- 11.1 Neni 43, i Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, përcakton se objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është dhe respektimi i rregullave të etikës.
- 11.2 Nga verifikimi dosjes së personelit dhe sistemit RMIS, rezultoi se ndaj subjektit të vlerësimit nuk ka masa disiplinore në fuqi apo të parashkruara për shkelje të rregullave të etikës, sipas përcaktimeve të nenit 43 të ligjit 12/2018, i ndryshuar.

12. Kualifikimet dhe trajnimet:

- 12.1 Nga verifikimi dosjes së personelit të subjektit si dhe verifikimit të pikës 3 të pjesës 3 të formularit të aftësive profesionale të dorëzuar nga subjekti, rezulton se është pajisur me

çertifikata për kryerje kursesh, shkollime dhe trajnime të ndryshme gjatë gjithë periudhës së punësimit të tij.

12.2 Megjithëse trajnimet e kryera nga subjekti nuk janë në periudhën sipas përcaktimeve të Nenit 44 pika 2 dhe 3 të Ligjit nr.12/2018, i ndryshuar, ato gjithsesi janë të lidhura me thellimin e njohurive, shtimin e vlerave dhe rritjen e performancës në ushtrimin e profesionit të profilit të tij.

12.3 Gjithashtu konstatohet se: Trajnimet dhe pajisja me çertifikata trajnimi janë të lidhura dhe në përputhje me objektin e ushtrimit të funksioneve të tij në detyra të ndryshme ku ka punuar.

13. Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshop-e, botime brenda ose jashtë vendit.

13.1 Duke ju referuar pikës 5 të pjesës 3 të formularit të aftësive profesionale të dorëzuar nga subjekti, ai nuk ka deklaruar se është angazhuar në pjesëmarrje të këtij lloji.

(Pjesëmarrjet në konferenca shkencore, nuk administrohen në dosjen e personelit pasi nuk janë pjesë e saj)

- ✓ *Në konkluzion për vlerësimin e aftësive profesionale, në përputhje me pikën 1 të nenit 47 të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, trupa vlerësuese, arrin në përfundimin se:*
- a) është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;*
 - b) ka vlerësime pozitive pune;*
 - c) ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban.*

V. KONKLZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa e Vlerësimit e Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e vlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet nga subjekti i vlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti i vlerësimit **Z. Ardit Elmazi**, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë,
- Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës,
- Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2, të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, Z. Ardit Selman Elmazi, me funksion aktual Drejtor, në Drejtorinë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Shkodër.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve, nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve, nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, sot datë **13.12.2024**.

TRUPA E VLERËSIMIT

Henri Naqellari
Kryesues

Loreta Hanxhari
Relatore

Bora Vrenjo
Anëtare